

DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA  
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË  
KOSOVËS

# RAPORTI I VITIT 2019



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E  
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës u krijuan në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, një amendamenti kushtetues dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës.

Ato janë të përkohshme dhe me mandat dhe juridiksion të përcaktuar për krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera të përkufizuara sipas ligjeve të Kosovës, të cilat pretendohen se kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë nga 1 janari i vitit 1998 deri më 31 dhjetor të vitit 2000 nga, apo kundër qytetarëve të Kosovës, apo të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës kanë një seli në Hagë, Holandë. Personeli i tyre që përfshin edhe gjykatësit, Prokurorin e Specializuar dhe Administratoren, është ndërkombëtar.

**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA  
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË  
KOSOVËS**

# **RAPORTI I VITIT 2019**



**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E  
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS**




# Përmbajtja

<b>DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS</b> . . . . .	7
Parathënie . . . . .	8
Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në . . . . .	10
Salla e gjyqit . . . . .	14
<b>DHOMAT</b> . . . . .	24
1. Veprimtaritë gjyqësore . . . . .	25
2. Veprimtaritë e Kryetares dhe të gjykatësve . . . . .	27
3. Marrëdhëniet me jashtë . . . . .	31
<b>ZYRA ADMINISTRATIVE</b> . . . . .	34
1. Kabineti i Administratores . . . . .	38
2. Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun . . . . .	39
Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim . . . . .	41
3. Zyra e Auditimit . . . . .	47
4. Zyra e Avokatit të Popullit . . . . .	48
5. Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore . . . . .	49
5.1. Njësia për Administrimin e Gjykatës . . . . .	50
Prezantimi i Legal Workflow . . . . .	50
5.2. Njësia e Përkthimit . . . . .	51
5.3. Zyra e Mbrojtjes (ZM) . . . . .	52
Rregullorja e ndihmës juridike . . . . .	52
Ngritja e organit përfaqësues të pavarur . . . . .	52
5.4. Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave . . . . .	53
5.5. Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve . . . . .	54
5.6. Njësia e Paraburgimit . . . . .	55
Funksioni i paraburgimit . . . . .	55
6. Seksioni i Administratës . . . . .	56
6.1. Njësia e Burimeve Njerëzore . . . . .	56
6.2. Njësia e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit . . . . .	58
6.3. Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme . . . . .	59
6.4. Njësia e Sigurisë . . . . .	60
6.5. Njësia e Financave dhe Buxhetit . . . . .	60
6.6. Njësia e Prokurimit . . . . .	61
<b>ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR</b> . . . . .	63
Parathënie . . . . .	64
Hetimet . . . . .	65
Historiku i ZPS-së . . . . .	66
Aktakuza . . . . .	66
Raportime diplomatike . . . . .	67
Personeli . . . . .	68
Personeli i lartë i Prokurorisë . . . . .	68



# Dhomat e Specializuara të Kosovës



# Parathënie

Është kënaqësi e madhe për ne t'ju paraqesim raportin vjetor të Dhomave të Specializuara të Kosovës për vitin 2019. Gjatë vitit të kaluar, institucioni ynë është rritur, duke u bërë një gjykatë me një kornizë të shëndoshë dhe gjithëpërfshirëse ligjore dhe administrative, me një sallë të re gjyqi në dispozicion të saj, si edhe me të gjitha mjetet praktike dhe logjistike të nevojshme për të mbështetur çdo proces të ardhshëm gjyqësor që do të paraqitet para Dhomave të Specializuara të Kosovës. Këto arritje kyçe si edhe shumë zhvillime të tjera që kanë ndodhur gjatë vitit 2019, do t'u mundësojnë Dhomave të Specializuara të Kosovës të përmbushin mandatin e tyre, për zhvillimin e procedurave penale të pavarura dhe të paanshme, të sigurta dhe të mbrojtura, efikase dhe të drejta.

Ky raport thekson arritjet kryesore të institucionit tonë gjatë vitit 2019 dhe paraqet shkurtimisht punën e bërë nga njësitë dhe seksionet e ndryshme gjatë këtij viti.

Një nga arritjet më të mëdha gjatë vitit 2019 ishte transferimi në mjediset e reja, ku kemi në dispozicion një sallë gjyqi krejtësisht të re për zhvillimin e çdo procedure gjyqësore në të ardhmen. Në përputhje me angazhimin e saj për transparencë, salla e gjyqit e Dhomave të Specializuara të Kosovës ka kapacitete për të transmetuar drejtpërdrejt proceset gjyqësore që zhvillohen aty në të tri gjuhët zyrtare dhe mundëson masa të ndryshme që garantojnë sigurinë e viktimave dhe dëshmitarëve, si dhe ka futur në përdorim një numër tiparësh novatore të cilat do të lehtësojnë kryerjen e procedurave efikase, të drejta, dhe të sigurta. Gjithashtu, kemi vënë në funksionim një platformë elektronike për administrimin e gjykatës, e cila u jep mundësi përdoruesve të bëjnë të njohura, të shohin, të analizojnë dhe të paraqesin prova brenda një sistemi të vetëm të integruar. Për këtë, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë ndaj qeverisë norvegjeze për ndihmën financiare që na ka ofruar për rinovimet e kryera, të cilat bënë të mundur zhvendosjen tonë në mjediset e reja.

Gjatë vitit 2019, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës u angazhuan shumë me përgatitjet për të siguruar procese efektive dhe efikase. Rritja e angazhimit të Prokurorisë së Specializuar në kryerjen e hetimeve gjatë vitit 2019, u bë shkas për ndërmarrjen e disa veprimtarive gjyqësore para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe kryerjen e vlerësimeve nga Zyra Administrative të rasteve të pamundësisë financiare në përputhje me Rregulloren e Përkohshme për Ndhimë Juridike. Përveç kësaj, Zyra Administrative mbështeti një grup pune për të krijuar një Organ Përfaqësues të Pavarur të Mbrojtësve të Specializuar (OPP). I përgëzojmë mbrojtësit për ngritjen e OPP-së dhe jemi të përkushtuar për një bashkëpunim të frytshëm me ta.

Po ashtu, Programi ynë për Komunikim dhe Ndërgjegjësim ka përparuar më tej gjatë vitit 2019. Përveç vizitave pothuaj të përmuajshme në Kosovë, ku ekipi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit është takuar me një gamë të gjerë përfaqësuesish nga shoqëria civile, Dhomat e Specializuara të Kosovës mirëpritën gjithashtu për herë të dytë 15 OJQ nga Rrjeti i Informimit të Gjykatës. Gjatë një seance dyditore, OJQ-të u dhanë Dhomave të Specializuara të Kosovës mendime të vyera për Programin e tyre për Komunikim dhe Ndërgjegjësim, duke lehtësuar kështu përhapjen e informacionit të saktë dhe transparent mbi punën dhe mandatin e Dhomave të Specializuara të Kosovës në rajon.

Ne mbetemi të përkushtuar për të siguruar që njerëzit që ndikohen më shumë nga puna e institucionit tonë të informohen për mandatin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe, sipas rastit, të mbahen në dijeni të çdo zhvillimi të rëndësishëm në institucionin tonë. Ne i marrim shumë seriozisht marrëdhëniet tona me komunitetet në Kosovë dhe gjetkë, dhe do të vijojmë të investojmë për zgjerimin e këtyre kontakteve dhe mbajtjen e një kanali aktiv dhe të hapur dialogu me këto komunitete. Për këtë qëllim, Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë publikuar fletëpalosje



informative si edhe video mbi strukturën dhe mandatin e gjykatës.

Dëshirojmë të falënderojmë qeverinë zvicerane për mbështetjen e saj bujare dhe të vazhdueshme financiare, që na ka lejuar ta zgjerojmë dhe forcojmë më tej Programin tonë për Komunikim dhe Ndërgjegjësim.

Arritjet e Dhomave të Specializuara të Kosovës gjatë vitit 2019 nuk do të kishin qenë të mundura pa mbështetjen e vazhdueshme të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të shteteve të treta kontribuese, të cilave u jemi tepër mirënjohëse. Po ashtu, përfshirja e përkushtuar e shtetit pritës, Holandës, ka qenë thelbësore për gjetjen e një zgjidhjeje në lidhje me objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe mbështetja e saj ka qenë vendimtare për sa i përket përfundimit të rinovimit të zyrave të reja.

Gjithashtu dëshirojmë t'u shprehim vlerësimin tonë të sinqertë homologëve tanë të Shërbimit të Jashtëm të Bashkimit Evropian, Shërbimit të Komisionit Evropian për Instrumentet e Politikës së Jashtme dhe të Zyrës së Kapaciteteve për Planifikim dhe Drejtim Civil për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre me

institucionin tonë gjatë vitit 2019.

U shprehim mirënjohje edhe shteteve anëtare të BE-së, anëtarëve të komunitetit diplomatik, si edhe gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë dhe të ndërkombëtarizuar në Hagë, për bashkëpunimin dhe shkëmbimet e rregullta konstruktive për çështje organizative dhe administrative.

Jemi krenarë për gjithçka që kemi arritur gjatë vitit 2019 dhe në veçanti i jemi mirënjohës personelit tonë për punën e palodhur për të siguruar jo vetëm funksionimin efikas të institucionit, por edhe për transferimin tonë në mjediset e reja në mënyrë shumë profesionale dhe pa shkaktuar probleme e vonesa në punën e institucionit.

Me krijimin e një kornize të qëndrueshme ligjore dhe normative dhe me një sallë gjyqi plotësisht funksionale në dispozicion, si edhe me përkushtimin e palëkundur të personelit, Dhomat e Specializuara të Kosovës janë të gatshme të zhvillojnë procese gjyqësore të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase, në përputhje me mandatin e tyre, duke shërbyer si model për institucione të tjera të ngjashme.

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova**  
*Kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës*

**Dr Fidelma Donlon**  
*Administratore e Dhomave të Specializuara të Kosovës*

*Hagë, shkurt 2020*

# Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në

Në qershor të vitit 2008, Komisioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut emëroi një raportues të posaçëm për hetimin e pretendimeve për krime të rënda të kryera nga disa pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë dhe pas konfliktit të viteve 1998-1999.

Në **janar 2011**, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi, me Rezolutën 1782 (2011), raportin e përgatitur nga raportuesi i posaçëm (Raporti i Këshillit të Evropës) në të cilin pretendohet se ishin kryer krime të shumta kundër serbëve, kundër shqiptarëve të Kosovës të dyshuar si bashkëpunëtorë të regjimit serb dhe kundër individëve të tjerë.

Në vijim të Raportit të Këshillit të Evropës, në **maj 2011**, shtetet anëtare të BE-së e shqyrtuan çështjen në kuadër të Komisionit Politik dhe të Sigurisë – organi që merret me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë. Pas kësaj u themelua Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e cila u ngarkua me detyrën e kryerjes së hetimeve të pavarura të pretendimeve për ndalim të paligjshëm, dëbim, veprime çnjerëzore, tortura dhe vrasje, si dhe për çdo vepër tjetër penale të lidhur me Raportin e Këshillit të Evropës. Me seli në Bruksel, TFHS-ja filloi operacionet e veta në **shtator të vitit 2011**.

Ndërkohë që vazhdonin hetimet, përmes Shkëmbimit të Letrave midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, në **prill 2014**, u arrit një marrëveshje ndërkombëtare për themelimin dhe funksionimin e dhomave të posaçme gjyqësore për ndjekjen penale të krimeve që mund të rezultojnë nga hetimet e TFHS-së.

**Shkëmbimi i Letrave** përcakton se këto dhoma gjyqësore të posaçme do të krijoheshin në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Këto dhoma gjyqësore dhe zyra e prokurorit të specializuar do të kishin statusin dhe rregulloren e tyre të procedurës dhe provave dhe do të përbëheshin vetëm nga punonjës dhe drejtues ndërkombëtarë. Në Shkëmbimin e Letrave thuhet gjithashtu se dhomat e posaçme gjyqësore do të kishin seli në një shtet të tretë dhe se procedurat e ndjeshme, ndër të cilat dëgjimi i dëshmitarëve, do të kryheshin jashtë Kosovës. Shkëmbimi i Letrave u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës me dy të tretat e votave në prill 2014 dhe u bë pjesë e legjislacionit të brendshëm. Ai ka epërsi ndaj ligjeve të Kosovës.

Në **korrik 2014**, Kryeprokurori i TFHS-së bëri një deklaratë në të cilën thuhej se “TFHS-ja është në gjendje të ngrejë aktakuzë ndaj disa zyrtarëve të lartë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.

Në **mars 2015**, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës një amendament kushtetues të propozuar nga qeveria e Kosovës, për vënien në jetë të Shkëmbimit të Letrave. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës duhej të vlerësonte nëse amendamenti i propozuar cenonte ndonjë prej të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kapitulli II i Kushtetutës. Në **prill 2015**, Gjykata Kushtetuese e Kosovës shpalli se amendamenti i propozuar ishte në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe se “struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe funksionimi i Dhomave të Specializuara do të rregullohen me ligje të tjera, në përputhje me Kushtetutën”.

Ky amendament hyri në fuqi me anë të nenit 162 të Kushtetutës së Kosovës nga Kuvendi i Kosovës në **gusht 2015**. Në të njëjtën kohë, u miratua gjithashtu edhe Ligji për themelimin e dy institucioneve, që është instrumenti themeltar i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Në **prill 2016**, dr. Fidelma Donlon u emërua Administratore e Dhomave të Specializuara, çka shënon fillimin e punës së Zyrës Administrative të DHSK-së në Hagëe.

Në **shtator 2016**, David Shvendiman (David Schwendiman) u emërua Prokuror i Specializuar.

Në **dhjetor 2016**, gjykatësja Ekaterina Trendafilova u emërua Kryetare e DHSK-së dhe filloi punë në janar 2017.

Më **1 janar 2017**, hyri në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës midis Kosovës dhe Holandës, sipas së cilës DHSK-ja mund të zhvillonte procedura penale në territorin e Holandës.

Pas kësaj, në **shkurt 2017**, nëntëmbëdhjetë gjykatës u emëruan në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtare të Dhomave të Specializuara. Në **mars 2017**, në Plenaren e parë, gjykatësit miratuan Rregulloren e Procedurës dhe Provave.

Pas një shqyrtimi kushtetues nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Rregullorja e Procedurës dhe Provave hyri në fuqi në **korrik 2017**, duke e bërë DHSK-në plotësisht funksionale në aspektin gjyqësor.

Në **nëntor 2017**, Administratorja miratoi Direktivën për Mbrojtësit, e cila, ndër të tjera, rregullon kriteret e përzgjedhjes së mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave në DHSK. Që atëherë, 167 juristë nga Kosova, Serbia, dhe një numër vendesh të tjera janë pranuar në Listën e Mbrojtësve të Specializuar dhe Mbrojtësve të Viktimave.

Në **maj 2018**, Pietro Spera u emërua Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Në **qershor 2018**, u ngrit Rrjeti i Informimit të Gjykatës, që përfshin OJQ vendore nga Kosova dhe Serbia.

Në **shtator 2018**, pas David Shvendimanit, në postin e Prokurorit të Specializuar u emërua Xhek Smith (Jack Smith).

Në **mars 2019**, gjykatësit e DHSK-së u mblodhën në seancën e katërt plenare. Në të njëjtin muaj, u miratua Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para DHSK-së.

Në **qershor 2019**, DHSK-ja dhe ZPS-ja u zhvendosën në mjediset e reja.

# Kronologji



## JANAR 2011

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (KiE) miraton një Raport mbi “Trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë”.

## SHTATOR 2011

Fillon punën Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e ngritur nga BE-ja për të kryer hetime penale në lidhje me pretendimet në Raportin e KiE-së.

## PRILL 2014

Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë shkëmbejnë letra në lidhje me krijimin e “Dhomave të veçanta gjyqësore”.

## GUSHT 2015

Kuvendi i Kosovës miraton nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

## JANAR 2017

Hyn në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës midis Kosovës dhe Holandës, duke i mundësuar DHSK-së zhvillimin e procedurave penale në Holandë.



## DHJETOR 2016

Gjykatësja Ekaterina Trendafilova emërohet Kryetare e DHSK-së.

## SHTATOR 2016

David Shvendiman emërohet Prokuror i Specializuar.



## PRILL 2016

Dr. Fidelma Donlon emërohet Administratore e DHSK-së, çka shënon fillimin e punës së institucionit gjyqësor në Hagë.

**SHKURT 2017**

Emërohen 19 gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë.

**MARS 2017**

Gjykatësit miratojnë Rregulloren e Procedurës dhe Provave, e cila do t'i nënshtrohej shqyrtimit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

**KORRIK 2017**

Hyn në fuqi Rregullorja e Procedurës dhe e Provave pas shqyrtimit të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese dhe DHSK-ja bëhet funksionale në aspektin gjyqësor.

**NËNTOR 2017**

Administratorja miraton Direktivën për Mbrojtësit, që rregullon çështje të tilla si kriteret e pranimit të mbrojtësve për të përfaqësuar të dyshuarit, të akuzuarit dhe viktimat përpara DHSK-së. Deri në fund të vitit 2019, 167 juristë ishin pranuar në Listat e Mbrojtësve të Specializuar dhe Mbrojtësve të Viktimave.

**QERSHOR 2019**

DHSK-ja dhe ZPS-ja transferohen në mjediset e reja.


**SHTATOR 2018**

Xhek Smith emërohet Prokuror i Specializuar pas David Shvendimanit.

**MAJ 2018**

Pietro Spera emërohet Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) janë dy institucione të pavarura, të ngritura pas një **Shkëmbimi Letrash** në përputhje me legjislacionin e Kosovës, me anë të një **amendamenti kushtetues** në 2015. **Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji)** u miratua nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015.



#### ■ Mandati i DHSK-së është

- "Të sigurojë procedura penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë, që ndërlidhen me ato të paraqitura në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës [...] dhe që kanë qenë objekt i hetimeve penale të Task Forcës Hetimore Speciale" (neni 1 i Ligjit).

#### ■ DHSK-ja është një institucion gjyqësor i përkohshëm

- Ajo do të ekzistojë vetëm për sa kohë që do të jetë e nevojshme për gjykimin e akuzave të paraqitura nga Prokurori i Specializuar dhe deri sa Këshilli i BE-së ta njoftojë Kosovën për përfundimin e hetimeve dhe procedurave.

#### ■ DHSK-ja është krijuar në përputhje me **Shkëmbimin e Letrave dhe legjislacionin e Kosovës** dhe

- ka të njëjtat **shkallë gjykimi** si sistemi gjyqësor i Kosovës (themelore, e apelit, supreme, kushtetuese)
- ka **seli jashtë Kosovës**
- përbëhet nga gjykatës dhe punonjës që janë **qytetarë të shteteve anëtare të BE-së** apo të shteteve të tjera kontribuese
- zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe të drejtën penale materiale të Kosovës sikundër parashikohet në Ligj
- zbaton **Rregulloren e vet të Procedurës dhe të Provave**

### ■ Juridiksioni i DHSK-së përfshin

- krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera sipas të drejtës penale të zbatueshme në kohën kur janë kryer këto krime.

që kanë ndodhur nga 1 janari i vitit 1998

- deri më 31 dhjetor të vitit 2000

që kanë filluar të kryhen apo janë kryer në

- Kosovë, ose janë kryer nga persona apo ndaj personave me shtetësi kosovare/të RFJ-së


- krime të caktuara kundër administrimit të drejtësisë kur kanë lidhje me procedurat zyrtare dhe/ose me zyrtarët e saj.

- DHSK-ja merret **vetëm me përgjegjësi penale individuale** - ajo nuk do të gjykojë grupe ose organizata.

- DHSK-ja lejon **pjesëmarrjen e viktimave** në procese.

- DHSK-ja dhe ZPS-ja financohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe nga shtete të treta kontribuese dhe janë të pavarura në përmbushjen e mandatit dhe kryerjen e punës së tyre.

- Gjuhët zyrtare të DHSK-së dhe ZPS-së janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja.





← Dronovs  
Wallemaat 2

← Katwijk 18






# SALLA E GJYQIT



Seancat gjyqësore përkthehen me gojë njëkohësisht në shqipe, serbishte, anglishte apo një gjuhë tjetër, sipas nevojës, dhe transmetohen drejtpërdrejt në të tri gjuhët e gjykatës.



Prokuroria.


Gjithashtu këtu ulen edhe mbrojtësit që kanë të drejtë të përfaqësojnë një grup viktimash pjesëmarrëse.

Gjykatësve të Regjistrit të Gjykatësve Ndërkombëtarë u caktohen çështje gjyqësore nga Kryetarja, e cila është e vetmja gjykatëse e përhershme në selinë e DHSK-së.



Legal Workflow, një sistem i integruar elektronik për administrimin e gjykatës, siguron procedura gjyqësore të sigurta dhe pa përdorim të dokumenteve të shtypura në letër.

Seancat gjyqësore janë të hapura për publikun, përveçse kur urdhërohet ndryshe nga paneli i gjykatësve. Masat mbrojtëse të urdhëruara nga gjykatësit, si seancat private dhe të mbyllura, kufizojnë qasjen e publikut në seancat gjyqësore.



Mbrojtësit e të akuzuarve që kanë të drejtë të përfaqësojnë para DHSK-së. Ekziston një sistem i ndihmës juridike për përfaqësimin e të dyshuarve dhe të akuzuarve të varfër.

Ky është vendi ku ulen dëshmitarët kur japin dëshmi, që ndodhet përballë podiumit të gjykatësve. Gjykatësit mund të urdhërojnë masa të ndryshme për të mbrojtur identitetin e dëshmitarit përpara, gjatë dhe pas procesit gjyqësor.






**DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
NË SALLËN E GJYQIT TË**



[Klikoni këtu për më shumë pamje nga salla e gjyqit.](#)

---

# Dhomat





# 1 | Veprimtaritë gjyqësore

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) u bënë funksionale në aspektin gjyqësor në korrik të vitit 2017, me hyrjen në fuqi të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (Rregullorja). Që atëherë, gjykatësit e DHSK-së kanë qenë të gatshëm të trajtojnë çdo çështje juridike, përfshirë çdo aktakuzë të mundshme që mund të paraqitet nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS). Megjithatë, vendimi nëse dhe kur do të paraqitet aktakuzë varet nga gjykimi i Prokurorit të Specializuar.

## PROCEDURA QË REZULTUAN PREJ FLETËTHIRRJEVE TË LËSHUARA NGA ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

Gjatë gjithë vitit 2019, Prokurori i Specializuar është angazhuar aktivisht në hetime dhe ka lëshuar një numër të madh fletëthirrjesh për të intervistuar disa individë si dëshmitarë apo si të dyshuar. Këto fletëthirrje, nga ana e tyre, janë bërë shkas për fillimin e veprimtarive gjyqësore në DHSK.

Më konkretisht, më 15 janar 2019, një nga personat e thirrur nga Prokurori i Specializuar si i dyshuar paraqiti ankesë në **Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (DHSGJK)**, sipas së cilës pretendonte se i ishin shkelur të drejtat e tij themelore nga një urdhër për dorëzimin e dokumenteve dhe të dhënave. Parashtruesi i kërkesës kërkoi që urdhri të pezullohej deri sa DHSGJK-ja të merrte një vendim lidhur me referimin e tij. Pas tërheqjes së fletëthirrjes nga Prokurori i Specializuar, DHSGJK-ja shpalli vendimin e saj në shkurt të vitit 2019, në të cilin konstatonte se referimi ishte i papranueshëm.

*[...] Duke marrë parasysh faktin se të drejtat kushtetuese të Parashtruesit për të heshtur dhe për të mos inkrimnuar vetveten janë ruajtur, Dhoma është e bindur se, në rrethanat e tanishme, ankesat e tij sipas nenit 30(6) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës janë të papranueshme për shkak të mungesës së statusit të viktimës.*

**KSC-CC-2019-05/F00012, Vendim për referimin e Mahir Hasanit në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë të 20 dhjetorit 2018, 20 shkurt 2019, para. 33.**

Më 23 shkurt 2019, një person i thirrur për intervistë apeloj vendimin e Administratores sipas të cilit atij i refuzohej ndihma juridike për të paguar mbrojtësin e tij gjatë intervistës me ZPS-në. Në përputhje me kornizën ligjore të DHSK-së, Kryetarja ia caktoi këtë apel një gjykatësi të vetëm i cili la në fuqi vendimin e Administratores për t'i refuzuar ndihmën juridike këtij individ.

*Duke marrë parasysh detyrimet e Administratores për miradministrimin financiar të Dhomave dhe duke u bazuar në vlerësimin e tërësisë së informacionit të dhënë nga Parashtruesi, vendimi për refuzimin e ndihmës juridike duke u bazuar, ndër të tjera, në mungesën e sqarimeve të mëtejshme të deklaratës vijuese të Parashtruesit, nuk ishte qartazi i paarsyeshëm.*

KSC-BC-2019-02/F00012/RED. Versioni publik i redaktuar i Vendimit mbi kërkesën për rishikim të një vendimi të Administratores në lidhje me ndihmën juridike, 25 mars 2019, para. 61.

Më 14 nëntor 2019, një person tjetër i thirrur nga Prokurori i Specializuar si i dyshuar paraqiti një kërkesë referuese para DHSGJK-së. Parashtruesi vinte në diskutim në përgjithësi ligjshmërinë e intervistës me Prokurorin e Specializuar. Deri në fund të vitit 2019, vendimi i formës së prerë i DHSGJK-së nuk kishte dalë ende.

## PROCEDURA TË APELIT TË PUNONJËSVE

Përveç veprimtarisë gjyqësore, që përbën veprimtarinë bazë të DHSK-së, DHSK-ja dhe ZPS-ja zhvillojnë edhe veprimtari gjyqësore që burojnë nga mekanizimi i brendshëm për apelet e personelit. Ky mekanizëm u jep pjesëtarëve të personelit mundësinë t'i drejtohen një **gjykatësi për apele të punonjësve** (si shkallë e parë apeli) dhe një **gjykatësi të lartë për apele të punonjësve** (si apel i shkallës së dytë) kur bëhet fjalë për çështje të lidhura me punësimin e tyre në DHSK dhe ZPS.

Gjatë vitit ka pasur një numër **apelesh të punonjësve** të lidhura me largimin e pritshëm të Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian (BE).

Gjithsej, u zhvilluan 13 procese të ndryshme, të cilat përfshinë tetë anëtarë britanikë të personelit që paraqitën apele kundër vendimeve të Administratores për përfundimin apo mosrinovimin e kontratave të tyre si rrjedhojë e daljes së pritshme të Britanisë së Madhe nga BE-ja. Si gjykatësve për apelet e punonjësve, ashtu dhe gjykatësve të lartë për apelet e punonjësve iu është dashur t'i gjykojnë këto apele dhe të jepnin një numër vendimesh dhe urdhrash për këto çështje. Në të gjitha rastet, u lanë në fuqi vendimet e Administratores.

Versionet publike të vendimeve janë të disponueshme në faqen e Internetit të DHSK-së.

DHSK-ja dhe ZPS-ja gëzojnë imunitet dhe, si rrjedhojë, nuk i nënshtrohen asnjë procedure ligjore në shtetin pritës apo gjatë. Rrjedhimisht, këto institucione kanë procedurën e tyre për apelet e punonjësve, për të siguruar që punonjësit e këtyre institucioneve të kenë mundësi të përdorin mjete efektive gjyqësore kur kundërshtojnë vendime të marra nga Administratorja e DHSK-së në lidhje me punën e tyre në këto institucione.

Për këtë qëllim, Administratorja miratoi Rregulloren e Personelit të **Dhomave të Specializuara**, dhe të Zyrës së **Prokurorit të Specializuar** e cila rregullon rekrutimin e punonjësve në këto institucione, që përfshin edhe një procedurë për apelet e punonjësve. Kryetarja, nga ana e saj, miratoi **Rregulloren e Procedurës për Apelet e Punonjësve**, e cila përshkruan me hollësi se si zhvillohet procesi i apeleve të punonjësve.

## 2 | Veprimtaritë e Kryetares dhe të gjykatësve

Gjykatësit e DHSK-së emërohen në Regjistrin e Gjykatësve dhe ushtrojnë funksione gjyqësore sipas nevojës, me kërkesën e Kryetares. Në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), gjykatësit nuk marrin shpërblim apo përfitime të tjera për shkak se janë në Regjistër dhe, për aq sa është e mundur, i ushtrojnë funksionet e tyre nga larg.



Gjykatësit e DHSK-së

Për shkak të përgjegjësive për administrimin gjyqësor të DHSK-së dhe për kryerjen e një numri funksionesh të tjera kritike që Kryetarja duhet t'i kryejë në bazë të Ligjit dhe të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Kryetare Ekaterina Trendafilova është e pranishme në selinë e DHSK-së dhe shërben me orar të plotë.

Gjatë vitit 2019, Kryetarja dhe gjykatësit morën pjesë në miratimin e dokumenteve të ndryshme ligjore, diskutuan rreth zhvillimeve në DHSK,

u përgatitën për aktivitetet e ardhshme gjyqësore, shkëmbyen mendime për praktikat më të mira dhe politikat e brendshme. Një prej këtyre dokumenteve ligjore të rëndësishme është **Udhëzuesi i Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara**, të cilin Administratorja e miratoi më 17 maj 2019, në bashkërendim me Kryetaren dhe pas konsultimeve me gjykatësit. Ky Udhëzues Pune rregullon mënyrën e paraqitjes së dokumenteve për protokollim në DHSK.

# Gjykatësit e Regjistrit të Gjykatësve Ndërkombëtarë



Gjykatëse Ekaterina  
Trendafilova  
Kryetare (Bullgari)



Gjykatës Keith Raynor \*  
Nënkryetar  
(Britania e Madhe)



Gjykatës Vidar Stensland  
Gjykatës kushtetues  
(Norvegji)



Gjykatës Roland Dekkers  
Gjykatës kushtetues  
(Holandë)



Gjykatëse Ann Power-Forde \*  
Gjykatëse kushtetuese  
(Irlandë)



Gjykatës Antonio Balsamo  
Gjykatës kushtetues rezervë  
(Itali)



Gjykatës Charles L. Smith, III  
(Shtetet e Bashkuara të  
Amerikës)



Gjykatëse Christine van den  
Wyngaert  
(Belgjikë)



Gjykatëse Michèle Picard  
(Francë)



Gjykatës Thomas Laker  
(Gjermani)



Gjykatës Emilio Gatti  
(Itali)



Gjykatës Michael Bohlander  
(Gjermani)



Gjykatës Kai Ambos  
(Gjermani)



Gjykatës Kenneth Roberts  
(Kanada)



Gjykatëse Mappie Veldt-  
Foglia  
(Holandë)



Gjykatës Christoph Barthe  
(Gjermani)



Gjykatës Vladimir Mikula  
(Republika Çeke)



Gjykatës Guénaél Mettraux  
(Zvicër)



Gjykatës Nicolas Guillou  
(Francë)



Gjykatës Andres Parmas \*  
(Estoni)

*Ndërkohë ka dhënë dorëheqjen \**

Në përputhje me rregullën 10 të Rregullores, e cila parashikon që seancat plenare të mbahen të paktën një herë në çdo vit kalendarik, gjykatësit u mbledhën në **Plenare** në zyrat e përkohshme të DHSK-së në Holandë në mars të vitit 2019. Gjatë Plenares, gjykatësit u informuan rreth zhvillimeve të fundit nga tre drejtuesit kryesorë dhe diskutuan mbi çështje që lidheshin me punën e tyre si gjykatës të DHSK-së.



*Plenarja, mars 2019*

Kryetarja caktoi dy gjykatës nga Regjistri për të marrë pjesë në **Komisionin për Rregulloren** për një afat kohor njëvjeçar, në përputhje me rregullën 7(1) të Rregullores. Komisioni i Rregullores mbledhet dhe kryesohet nga Kryetarja e DHSK-së.

Në parim, Komisioni i Rregullores shqyrton ndryshimet e propozuara në Rregullore vetëm kur ato janë **testuar**, për shembull, gjatë hetimeve të kryera nga Prokurori i Specializuar.

Pas shqyrtimit, Komisioni i Rregullores paraqet një raport ku parashtron mendimet e tij në lidhje me ndryshimet e propozuara në Rregullore, të cilat do të diskutohen nga gjykatësit gjatë Plenares vjetore të 2020. Propozimet për ndryshime në Rregullore miratohen nga Plenarja me shumicë absolute të gjykatësve të pranishëm, në përputhje me rregullat 7(5) dhe 11 të Rregullores.

Më 28 dhe 29 tetor të vitit 2019, Instituti Ndërkombëtar i Sirakuzës për Drejtësinë Penale dhe të Drejtat e Njeriut organizoi një **seminar** dyditor për gjykatësit e DHSK-së në Sirakuzë, Itali, ku gjykatësit shkëmbyen mendime për çështje që kanë të bëjnë me punën e tyre dhe funksionimin efikas të DHSK-së.



*Seminari në Sirakuzë, tetor 2019*

### 3 | Marrëdhëniet me jashtë

Gjatë vitit 2019, Kryetare Trendafilova ka punuar për të mbajtur publikun dhe palët e interesuara të informuara në lidhje me aktivitetet e DHSK-së. Për këtë qëllim Kryetarja është takuar me përfaqësues të institucioneve të BE-së, të shteteve anëtare, të shtetit pritës dhe të shteteve të treta kontribuuese.



Kryetare Trendafilova

Më 28 qershor 2019, tre drejtuesit pritën Komitetin Politik dhe të Sigurisë së BE-së në mjediset e reja në Hagë. Kryetare Trendafilova, së bashku me Prokurorin e Specializuar dhe Administratoren i informuan ambasadorët për punën dhe zhvillimet e fundit në DHSK dhe ZPS.

Shtetet anëtare të BE-së ritheksuan mbështetjen e tyre të fortë për punën e institucioneve, për të cilën drejtuesit shprehën mirënjohjen e tyre.

Më 10 dhjetor 2019, Kryetarja, së bashku me Prokurorin e Specializuar dhe Administratoren, i informuan shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuuese mbi punën e institucioneve në mjediset e reja të DHSK-së dhe ZPS-së. Ky ishte informimi i tretë i këtij lloji nga tre drejtuesit dhe kishte për qëllim të siguronte që anëtarët e komunitetit diplomatik në Hagë të mbahen të informuar rreth veprimtarive të vazhdueshme të DHSK-së dhe ZPS-së dhe sfidave aktuale në mënyrë transparente dhe efektive.

Për të forcuar më tej marrëdhëniet e DHSK-së me aktorë të tjetër të jashtëm dhe me shoqërinë civile, Kryetarja ka zhvilluar takime me anëtarë të komuniteteve diplomatike, ligjore, gazetareske dhe akademike. Kryetarja gjithashtu ka dhënë një numër intervistash dhe ka qenë ligjëruesja kryesore në një numër aktivitetesh gjatë të cilave ka folur edhe për punën dhe mandatin e DHSK-së.

*Lufta kundër pandëshkueshmërisë, lufta për të siguruar që ata që janë përgjegjës për një krim, qoftë krim i organizuar apo krim luftime dhe për krime kundër njerëzimit, nuk mund të bëhet vetëm. Kjo është një betejë që duhet të zhvillohet në të gjitha nivelet e shoqërisë; lokale, rajonale dhe në shkallë ndërkombëtare, dhe është një betejë në të cilën të gjithë ne jemi të interesuar. Kjo është një betejë që kërkon bashkëpunim të shëndoshë në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe midis shteteve në nivel evropian dhe në shkallë ndërkombëtare*

**Kryetare Trendafilova, artikull redaktorial, Nderim për Xhovani Falkonen, prill 2019**








*Vizita e Komitetit Politik dhe të Sigurisë së BE-së, qershor 2019*

---

# Zyra Administrative



# Zyra Administrative

Zyra Administrative, nën drejtimin e Administratores, është përgjegjëse për administrimin dhe shërbimet që lidhen me Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe të gjitha funksionet e nevojshme të ndërlidhura me to. Në përputhje me nenin 34 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), Administratorja nxjerr rregullore dhe udhëzime të brendshme të nevojshme në këtë drejtim dhe është e pavarur në kryerjen e funksioneve të saj.

Funksionet mbështetëse gjyqësore që ofron Zyra Administrative përfshijnë mbrojtjen dhe mbështetjen e dëshmitarëve, administrimin e Listës së Mbrojtësve, administrimin e sistemeve të ndihmës juridike dhe të pjesëmarrjes së viktimave, shërbimin e përkthimit me shkrim dhe me gojë dhe administrimin e gjykatës. Funksionet e mbështetjes administrative që Zyra Administrative ia ofron Dhomave dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) përfshijnë buxhetin, financat, prokurimin, teknologjinë e informacionit, administrimin e objekteve, burimet njerëzore dhe sigurinë. Administrimi i objekteve të paraburgimit të DHSK-së është gjithashtu një funksion i Zyrës Administrative.

Në 2019, funksionet e Zyrës Administrative kaluan nga finalizimi i shërbimeve të nevojshme dhe i kornizës administrative të DHSK-së, në zbatimin e proceseve të vendosura. Këto përfshinin, ndër të tjera, përparimin e punës për ngritjen e objektit të paraburgimit të DHSK-së, zbatimin e sistemit të ndihmës juridike dhe shtrirjen e përdorimit të Legal Workflow, sistemit elektronik për administrimin e punës gjyqësore të Gjykatës, për të gjithë përdoruesit.

Një nga arritjet më të mëdha të realizuara në 2019 ishte fillimi i punës në mjediset e reja në Hagë. Kjo erdhi si rezultat i një projekti rinovimi të nisur më 2017 dhe që përfundoi në sajë të bashkëpunimit të gjerë të mbarë institucionit me shtetin pritës dhe falë financimit të qeverisë norvegjeze. Me përfundimin e

punimeve dhe kalimin në mjediset e rinovuara, tani DHSK-ja ka një ndërtesë të sajën që i përshtatet qëllimit të saj.

Salla e gjyqit është qendra e kompleksit dhe të gjitha funksionet janë projektuar rreth saj, për sigurimin e një mjedisi të sigurt dhe të mbrojtur që mundëson procese të drejta dhe të pavarura. Pranë sallës ka mjedise më vete për dëshmitarët, të paraburgosurit, publikun dhe median. Salla e konferencave të shtypit është e pajisur për mundësimin e përkthimit simultan në tri gjuhët e gjykatës dhe ngjitur me të ka një hapësirë ku mund të punojnë gazetarët. Në ndërtesë ka hapësira të mjaftueshme për ekipet e ardhshme të mbrojtësve ku ata mund të punojnë për ecurinë e mëtejshme të proceseve gjyqësore.

Për sa i takon aspektit administrativ, më 2019, Zyra Administrative e shtoi më tej mbështetjen e saj për ZPS-së, duke përfshirë në fusha si TI dhe shërbimet gjuhësore, me qëllim që Prokurori i Specializuar të mund t'i përqendronte të gjitha burimet që disponon në kryerjen e hetimeve.

Gjatë vitit 2019, Administratorja miratoi një numër aktesh të rëndësishme administrative. Më i rëndësishmi ndër ta është Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para DHSK-së, i cili u miratua pas konsultimeve me Kryetaren, Prokurorin e Specializuar, gjykatësit dhe përfaqësues të mbrojtësve. Gjithashtu, Administratorja miratoi edhe Rregulloren e Përkohshme për Ndihmë Juridike, Strategjinë kundër Ngacmimeve, Procedurën Standarde të Punës për Procesin Disiplinor, si edhe politika dhe udhëzime lidhur me shërbimet e përkthimit me gojë dhe me shkrim dhe Udhëzuesin e Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para DHSK-së.

Dr. Fidelma Donlon është Administratorja e DHSK-së që nga emërimi i saj në prill të vitit 2016. Ajo është nënshkruesja e marrëveshjes për subvencionim në emër të DHSK-së dhe ZPS-së, dhe përgjigjet për miradministrimin e fondeve të caktuara për punën e tyre. Përgjegjësitë e saj përfshijnë komunikimet e jashtme dhe marrëdhëniet diplomatike, si edhe negocimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Shtetet.

Gjatë gjithë vitit ka pasur bashkëpunim të gjerë me shtetin pritës në lidhje me finalizimin e mjediseve të reja, si edhe me shërbimet e paraburgimit që shteti pritës i ofron DHSK-së. Nga fundi i vitit të gjitha detajet që kishin mbetur pa përfunduar u përfunduan, duke bërë të mundur që DHSK-ja të përgatitej për punën në objektin e paraburgimit në fillim të 2020.

Pas transferimit në mjediset e reja, Administratorja kontaktoi gjithashtu me shoqatën e lagjes ku ndodhet ndërtesa dhe u takua me përfaqësuesin e kësaj zone në bashki.


Administratorja u takua me një numër përfaqësuesish të shteteve anëtare të BE-së për çështje që lidhen me funksionimin e gjykatës dhe për t'u bërë ftesë të emëronin punonjës të përshtatshëm për atashim në poste në DHSK. Përveç pritjes së Komitetit të BE-së për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave në muajin shkurt, së bashku me Kryetaren dhe Prokurorin e Specializuar, si dhe të Ambasadorëve të Komitetit Politik dhe të Sigurisë të BE-së në qershor, Administratorja u takua gjithashtu edhe me Përfaqësuesin Evropian për të Drejtat e Njeriut, zotin Imën Gilmore (Eamon Gilmore), në nëntor.

Në dhjetor, gjatë raportimit vjetor në Hagë, tre drejtuesit i raportuan shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese për zhvillimet më të fundit.

Administratorja ka ligjëruar në një numër konferencash dhe aktiviteteve të mbajtura gjatë 2019, ndër të tjera, në Kiev, Ukrainë, në konferencën 'Përgjegjësia për Krimet e Rënda: GJPN-ja dhe Opsionet Plotësuese për Ukrainën', në raportimin në Qendrën Ndërkombëtare të Drejtësisë Tranzitore (ICTJ) mbi procesin e drejtësisë tranzitore në Kolumbi, dhe në Tryezën e Rrumbullakët të Ekspertëve, të organizuar nga Programi për Gjykatën Penale Ndërkombëtare dhe të Drejtën Penale Ndërkombëtare i Shoqatës Ndërkombëtare të Avokatëve, me titull 'Çuarja deri në fund e drejtësisë: probleme afatgjata në drejtësinë ndërkombëtare'.



Administratore Fidelma Donlon



# 1 | Kabineti i Administratores

Kabineti i Administratores mbështet punën e Administratores si dhe ndihmon në menaxhimin e marrëdhënieve diplomatike me shtetin pritës, shtetet anëtare të BE-së, shtetet e treta kontribuese dhe shtete të tjera, si edhe me organizata ndërkombëtare. Administrimi i informacionit (InfoGov) është gjithashtu pjesë e përgjegjësisë të Kabinetit të Administratores.

Kabineti i Administratores jep këshilla juridike për një larmi temash, përfshirë zbatimin e Marrëveshjes me Shtetin Pritës, për dokumente të brendshme të tilla si Rregullorja për Punonjësit dhe Kodi i Etikës Profesionale për Punonjësit, privilegjet dhe imunitetet, bashkëpunimin me shtetet, dhe për rregulloret e Zyrës Administrative për drejtimin administrativ. Kabineti gjithashtu i jep këshilla Administratores gjatë procedurave të apeleve të punonjësve para Gjykatësit dhe Gjykatësit të Lartë për Apelet e Punonjësve. Në vitin 2019, Administratores iu paraqitën 27 kërkesa për shqyrtim nga anëtarë të personelit . Katërmbëdhjetë vendime të shqyrtuara nga Administratorja u apeluan para Gjykatësit për Apelet e Punonjësve, i cili la në fuqi konstatimet e Administratores. Gjykatësi i Lartë për Apelet e Punonjësve la në fuqi vendimet e Gjykatësit për Apelet e Punonjësve në shtatë apele që iu paraqitën për shqyrtim.

Në 2019, u plotësuan dhe forcuan më tej korniza ligjore për mbështetjen e proceseve gjyqësore dhe rregulloret e administrimit të brendshëm. Plotësime dhe përf forcime të rregulloreve të brendshme u bënë veçanërisht në fushat e ndalimit të ngacmimeve në punë dhe të proceseve disiplinore, të administrimit të burimeve njerëzore dhe të financave.

Kabineti i Administratores ka punuar gjithashtu edhe për forcimin e marrëveshjeve të punës midis DHSK-së dhe ZPS-së dhe me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Organeve të Zbatimit të Ligjit.

InfoGov ofron këshilla strategjike për administrimin e sigurt të informacionit dhe zbatimin e tij efikas në të gjithë institucionin. Përmes administrimit efikas të informacionit, dokumenteve dhe të arkivave të DHSK-së, mbrohet siguria e informacioneve të ndjeshme.

Gjatë 2019, InfoGov vijoi të mbështeste personelin në lidhje me zbatimin e Udhëzimit Operativ për Mbrojtjen e Aseteve të Informacionit, i cili përmban udhëzime për trajtimin e informacionit të klasifikuar. Ai ofroi trajnime për personelin e DHSK-së dhe ZPS-së.

Kontrollet e sigurisë së informacionit u përmirësuan përmes organizimit të seancave mujore me punonjës të rinj dhe praktikantë, për t'i informuar ata për çështje të sigurisë, administrimit të ndryshimeve të lejeve për qasje në dokumente, shërbimeve të shifrimit/deshifrimit dhe kryerjes së vlerësimeve të rreziqeve. InfoGov ka punuar gjithashtu ngushtësisht me Njësinë e Mbështetjes Juridike të Dhomave dhe me njësitë administrative për t'u përgatitur për punë të sigurt në distancë të gjykatësve dhe ka vijuar të ofrojë shërbime të bibliotekës dhe mbështetje kërkimore për DHSK-në dhe ZPS-në.

## 2 | Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun

Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun (NJIKP) drejton komunikimet me publikun dhe veprimtaritë komunikuese dhe ndërgjegjësuere të DHSK-së.

Interesi për DHSK-në dhe punën e saj është rritur shumë gjatë 2019 si nga mediat ndërkombëtare dhe rajonale, ashtu edhe nga popullatat në Kosovë dhe Serbi që ndikohen nga veprimtaria e këtij institucioni. Duke u mbështetur në mësimet e nxjerra dhe punën me shoqërinë civile gjatë vitit 2018, si edhe në komentet e rjetit të partnerëve të shoqërisë civile në rajon, gjykata ka zhvilluar takime të rregullta komunikimi dhe ndërgjegjësimi në mbarë Kosovën gjatë 2019. Me qëllim që të shtrijë aktivitetin e saj përtej pjesëmarrësve në veprimtaritë e DHSK-së, NJIKP-ja ka përgatitur fletëpalosje të shkurtra informuese dhe video të ndryshme në lidhje me mandatin dhe aktivitetet e gjykatës në të tri gjuhët zyrtare të saj – shqipe, serbishte dhe anglishte. Puna me median në vitin 2019 përfshiu tryeza të rrumbullakëta me gazetarë në Kosovë dhe një numër më të madh intervistash në media nga përfaqësues të DHSK-së.

### Marrëdhëniet me mediat

NJIKP-ja u është përgjigjur aktivisht pyetjeve të medias dhe ka zhvilluar konsultime dhe tryeza të rrumbullakëta me gazetarë në Kosovë, për t'u dhënë informacion lidhur me DHSK-në, me synimin për të pasur më shumë raportime të balancuara mbi gjykatën dhe për të lehtësuar raportimin e saktë të gjyqimeve në të ardhmen.

Në dhjetor të vitit 2019, DHSK-ja priti një grup gazetarësh nga Evropa Juglindore, organizuar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN). U diskutua edhe për komunikimin e ardhshëm midis gazetarëve dhe DHSK-së pasi të fillojnë proceset gjyqësore.



Vizita e BIRN-it, dhjetor 2019

## Programi për Vizitorët i DHSK-së

Në vitin 2019, Dhomat e Specializuara të Kosovës u vizituan nga më se 600 studentë dhe juristë nga e gjithë bota. Në shtator, DHSK-ja mori pjesë në Ditën e Hapur Ndërkombëtare që organizohet çdo vit në Hagë, duke u mundësuar anëtarëve të publikut të interesuar të vizitonin mjediset e reja dhe duke u ofruar informacion rreth institucionit dhe veprimtarive të tij.



*Dita e Hapur Ndërkombëtare në Hagë, shtator 2019*



*Vizitë e një grupi studentësh, korrik 2019*



## 2.1 | Programi i DHSK-së për Komunikim dhe Ndërgjegjësim

Kontaktet me komunitetet që preken nga puna e DHSK-së kanë qenë përparësi e vazhdueshme që në fazat fillestare të planifikimit të gjykatës, dhe Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim përbën një prej elementëve qendrorë të Strategjisë së Komunikimit të miratuar nga Administratorja. Duke pasur parasysh se DHSK-ja është e zhvendosur në Holandë, është me rëndësi jetike që njerëzit në Kosovë dhe në rajon të kenë qasje në informacione të sakta dhe transparente në lidhje me mandatin dhe veprimtaritë e gjykatës, si dhe të kenë mundësi të bëjnë pyetje, të ngrenë shqetësime dhe të përfshihen në dialog për të sqaruar keqkuptimet ose idetë e gabuara.

Në sajë të një kontributi bujar dyvjeçar të qeverisë zvicerane, DHSK-ja mundi ta shtonte vazhdimisht numrin e veprimtarive të saj të komunikimit dhe ndërgjegjësimit në Kosovë më 2018 dhe 2019. Më 2019, NJIKP-ja dhe përfaqësues të njësive të tjera të DHSK-së vazhduan të kryenin vizita gati të përmuajshme komunikimi dhe ndërgjegjësimi në Kosovë. Gjatë çdo vizite janë mbajtur deri në katër aktivitete në komunitete të ndryshme dhe me grupe të ndryshme të synuara. Takimet komunikuese dhe ndërgjegjësuese janë organizuar përgjithësisht përmes OJQ-ve partnere në Kosovë, ndërsa DHSK-ja ka dërguar ligjërues, ndër të cilët shpesh kanë qenë zyrtarë në poste kyçe si shefja e Zyrës për Pjesëmarrjen e Viktimave, këshilltari juridik i Avokatit të Popullit dhe shefja e Informimit dhe Komunikimit me Publikun.



*Aktivitet komunikimi dhe ndërgjegjësimi në Universitetin e Prizrenit, Kosovë, nëntor 2019*

## Veprimtari kryesore komunikimi dhe ndërgjegjësimi

- Gjatë 2018-2019 u mbajtën 53 aktivitete në zona të banuara nga shumica dhe pakicat në 17 komunitete të ndryshme në Kosovë, me rreth 1.300 pjesëmarrës.
- Është vendosur dhe ka vazhduar dialogu me shoqërinë civile, udhëheqësit e komuniteteve, studentët dhe të rinjtë, shoqatat e familjeve të personave të zhdukur dhe të vrarë dhe me komunitetet profesionale të fushës së ligjit në Kosovë dhe Serbi.
- Pjesëmarrësit e pyetur në aktivitetet komunikuese dhe ndërgjegjësuese u shprehën shumë të kënaqur me informacionin e ofruar dhe përgjigjet e dhëna për pyetjet dhe shqetësimet e ngritura.
- Faza II e Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim filloi në fund të vitit 2019, me objektiv përhapjen e mesazheve kyçe të gjykatës tek publiku i gjerë, duke intensifikuar bashkëpunimin me palët e interesuara në Kosovë dhe duke dhënë informacion mbi fazat paraprake dhe të gjyqimit të procedurave gjyqësore.

Gjatë fazës së parë, Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim u përqendrua në vendosjen e një dialogu me shoqërinë civile dhe në krijimin e një Rrjeti të Informimit të Gjykatës (RRIGJ) i përbërë nga 15 OJQ nga Kosova dhe Serbia. Mesazhet kyçe u përqendruan në dhënien e informacioneve bazë rreth institucionit. Në fund të 2019, DHSK-ja nisi fazën II të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim, duke zbatuar komentet e vlefshme që kishte marrë nga Rrjeti i Informimit të Gjykatës. Takimet komunikuese dhe ndërgjegjësuese kaluan nga prezantimet me pyetje dhe përgjigje, tek diskutime të moderuara për t'iu përgjigjur më mirë shqetësimeve dhe nevojave të audiencave përkatëse dhe mbulimi nga media i aktiviteteve të komunikimit dhe ndërgjegjësimit u intensifikua. Gjithashtu, NJIKP-ja përgatiti një material filmik mbi Programin për Komunikim dhe Ndërgjegjësim, i cili mund të shihet në faqen e internetit të DHSK-së dhe në kanalën YouTube, si edhe një intervistë të zgjeruar me punonjës të DHSK-së në bashkëpunim me një OJQ partnere gjatë një vizite komunikuese dhe ndërgjegjësuese në Kosovë.



## Rrjeti i Informimit të Gjykatës

Në korrik të vitit 2019, DHSK-ja ftoi për herë të dytë në zyrat e saj në Hagë Rrjetin e Informimit të Gjykatës të përbërë nga 15 OJQ nga Kosova dhe Serbia. Gjatë seminarit, OJQ-të partnere analizuan aktivitetet e kryera dhe bënë sugjerime për të ardhmen. Partnerët u shprehën se ishte krijuar një bazë e fortë në lidhje me vendosjen e një dialogu me shoqërinë civile në Kosovë dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive në aktivitete të tilla dhe bënë rekomandime për rritjen e angazhimit me median dhe për një prani më të madhe në mediat sociale.

Në kuadër të seminarit, pjesëmarrësit shqyrtuan edhe materialet informative të DHSK-së. Këshillat e tyre për të përdorur një gjuhë më të thjeshtë dhe më pak teknike u morën parasysh në prodhimin e një materiali të ri informues nga fundi i vitit 2019, lidhur me procedurën paraprake dhe Avokatin e Popullit.



Takimi i RRIGJ-së, korrik 2019





*Intervistë televizive me përfaqësues të DSHK-së në Kosovë, dhjetor 2019*

## Disa aktivitete komunikuese dhe ndërgjegjësuere

- Prezantim nga shefja e Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave dhe shefi i Zyrës së Mbrojtjes para anëtarëve të Odës së Avokatëve të Serbisë – Beograd, janar 2019
- Takimi i dytë i Rrjetit të Informimit të Gjykatës – Hagë, korrik 2019
- Tryezë e rrumbullakët me avokatë dhe organizata të shoqërisë civile, mbajtur në bashkëpunim me Qendrën e Avokatisë për Kulturë Demokratike – Mitrovicë e Veriut, shkurt 2019
- Tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të pakicave dhe zyrtarë të komunave në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për Çështjet e Pakicave, Kosovë – Prizren, gusht 2019
- Seminar për të rinj me nxënës të shkollave të mesme dhe studentë të universitetit nga Lipjani, organizuar në bashkëpunim me Nismën Rinore për të Drejtat e Njeriut – Prishtinë, shkurt 2019
- Seminar për të rinj me nxënës të shkollave të mesme, organizuar në bashkëpunim me Nismën Rinore për të Drejtat e Njeriut – Kaçanik, shtator 2019
- Ligjëratë me studentë të drejtësisë, organizuar në bashkëpunim me Fondin për të Drejtën Humanitare në Kosovë – Fushë Kosovë, prill 2019
- Tryezë e rrumbullakët me gazetarë, organizuar në bashkëpunim me Fondin për të Drejtën Humanitare, Kosovë. – Prishtinë, tetor 2019
- Tryezë e rrumbullakët me shoqatat e personave të zhdukur, shoqatat e personave të zhvendosur brenda vendit dhe përfaqësues të pakicave, organizuar në bashkëpunim me OJQ-në AKTIV – Shtërpçë, qershor 2019
- Intervistë televizive me përfaqësues të DHSK-së, Zyrës së Avokatit të Popullit, sistemit të pjesëmarrjes dhe të komunikimit dhe ndërgjegjësimit të viktimave - Mitrovicë e Veriut, dhjetor 2019

### 3 | Zyra e Auditimit

Audituesja e brendshme kontribuon në administrimin dhe llogaridhënien institucionale të DHSK-së dhe ZPS-së përmes kryerjes së auditimeve, për të cilat ajo i raporton në vijim Administratores. Në punën e saj, audituesja u përmbahet standardeve ndërkombëtare profesionale të auditimit të brendshëm dhe rregulloreve financiare të BE-së, dhe këshillon mbi masat që duhen marrë për përmirësimin e drejtimit të punës.

Gjatë vitit 2019, audituesja e brendshme kreu gjashtë auditime në përputhje me planin e brendshëm të auditimit.

Këto auditime u përqendruan tek shpenzimet, administrimi i kontratave, pagat, fondi i kursimeve, dhe administrimi i ndihmës juridike. Përveç kësaj, u kryen edhe gjashtë auditime të tjera vijuese. Pas miratimit të "Strategjisë kundër mashtrimeve deri në qershor të vitit 2020", audituesja e brendshme organizoi trajnime për personelin në lidhje me parandalimin e mashtrimeve.

## 4 | Zyra e Avokatit të Popullit

Zyra e Avokatit të Popullit e Dhomave të Specializuara të Kosovës, ndonëse përfshihet si strukturë brenda Zyrës Administrative, vepron në mënyrë të pavarur për të monitoruar, mbrojtur dhe ruajtur të drejtat dhe liritë themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS). Ngritja e Zyrës së Avokatit të Popullit brenda strukturës së DHSK-së dhe ZPS-së është diçka e veçantë, në kuptimin që ofron një shtresë më shumë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave që ndërveprojnë me këto institucione.



Avokati i Popullit Pietro Spera

Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës është Pietro Spera, gjykatës nga Italia, i cili u emërua në këtë post në maj të 2018.

Në kuadër të punës së saj, Zyra e Avokatit të Popullit ka vënë në funksionim një procedurë efikase për ankesa, përmes të cilës individët që ndërveprojnë me DHSK-në apo ZPS-në mund të paraqesin ankesa për shkelje të pretenduara të të drejtave të tyre themelore nga këto dy institucione. Pas marrjes së ankesës, Avokati i Popullit e shqyrton ankesën dhe, kur është e përshtatshme, kryen hetime për shkeljet e pretenduara. Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit nxjerr një raport përfundimtar me rekomandime për Kryetaren e DHSK-së, apo për Prokurorin e Specializuar, sipas rastit.

Në vitin 2019, Avokatit të Popullit iu paraqitën tetë ankesa. Të gjitha ankesat kanë marrë përgjigje përfundimtare nga Avokati i Popullit. Nga të tetë rastet e trajtuara, gjashtë u gjykuan të papranueshme, mbi bazën se ankuesit nuk kishin argumentuar apo vërtetuar se DHSK-ja apo ZPS-ja ishin përfshirë në çfarëdo cilësie në çështjet për të cilat ishin bërë ankesat. Dy çështjet e tjera u zgjidhën me anë të ndërmjetësimit, nga i cili palët përkatëse mbetën të kënaqura.

Gjatë vitit, Zyra e Avokatit të Popullit kreu një numër vizitash në Kosovë dhe më gjerë në rajon, dhe u angazhua në veprimtari komunikimi dhe ndërgjegjësimi që synonin informimin e publikut në lidhje me rolin dhe funksionet e Avokatit të Popullit të DHSK-së. Ndër këto aktiviteteve të komunikimit dhe ndërgjegjësimit ishin angazhimi me shoqërinë civile, OJQ-të dhe studentët e universiteteve, si edhe pjesëmarrja në intervista televizive.

Në kuadër të funksionit monitorues, Avokati i Popullit vazhdoi t'u ofronte këshilla DHSK-së dhe ZPS-së me synim sigurimin e përmbushjes së përpiktë të standardeve më të larta të të drejtave të njeriut.



## 5 | Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore

Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore u ofron mbështetje ligjore dhe operative DHSK-së dhe ZPS-së përmes zyrave dhe njësive që përbëjnë këtë seksion. Këto janë Njësia për Administrimin e Gjykatës; Njësia e Përkthimit; Zyra e Mbrojtjes; Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave; Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve; dhe Njësia e Paraburgimit. Pjesë e këtij seksioni është gjithashtu edhe Njësia e Mbështetjes Juridike të Dhomave.

Në përgatitje për proceset e ardhshme, fokusi i këtij seksioni gjatë gjithë vitit 2019 ka qenë konsolidimi i mëtejshëm i punës së madhe të bërë që nga krijimi i

DHSK-së, për të siguruar ofrimin e shërbimeve profesionale të nivelit më të lartë të mundshëm. Kjo ka përfshirë punën për finalizimin e kornizës ligjore dhe administrative që rregullon punën e seksionit dhe për sigurimin e burimeve të nevojshme njerëzore dhe teknike. Gjithashtu, me dy seanca të panelit të Gjykatës Kushtetuese të mbajtura në 2019, si edhe me veprimtari të tjera gjyqësore të lidhura me skemën e ndihmës juridike dhe apelet e punonjësve, në vitin 2019 u vunë në zbatim me sukses elementë të rëndësishëm të mbështetjes së seksionit për DHSK-në.

## 5.1 | Njësia për Administrimin e Gjykatës

Njësia për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ) administron dokumentacionin gjyqësor, duke përfshirë edhe të gjitha parashtrimet për protokollim dhe provat fizike. Në gjashtë muajt e parë të vitit u krijua korniza ligjore që rregullon përgjegjësitë kryesore të njësisë, me nxjerrjen e dokumenteve të rëndësishme, ndër të cilat, Udhëzuesi i Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara dhe Udhëzimi i Zyrës Administrative për Parashtrimin e Kërkesave për Përkthim me Shkrim dhe me Gojë dhe Kërkesave për Verifikim. Është me rëndësi të vihet në dukje se fillimi i aktiviteteve gjyqësore të lidhura me hetimet, të tilla si kërkesat referuese në Gjykatën Kushtetuese, dhe me çështje të ndihmës juridike dhe me apelet e punonjësve, sollën rritjen e numrit të parashtrimeve të protokolluara dhe organizimin e seancave të para në DHSK.

### Vënia në funksionim e sistemit elektronik Legal Workflow

Në vijim të nxjerrjes së dy udhëzimeve të tjera nga Zyra Administrative, në të gjithë institucionin hyri në funksionim sistemi elektronik i administrimit të gjykatës, Legal Workflow. Sistemi u mundëson palëve në procedura të administrojnë dokumentacionin e lëndëve në mënyrë elektronike si edhe të shohin, analizojnë, nxjerrin dhe paraqesin të gjitha provat brenda një sistemi të integruar. U organizuan seanca trajnimit për të gjithë përdoruesit e rinj të sistemit. Gjatë gjithë 2019, u futën disa tipare të reja, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe

lehtësimin e nxjerrjes së informacionit procedural për të gjithë përdoruesit e Legal Workflow. Për shembull, një modul i ri i mundëson Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave t'i kryejë të gjitha proceset e punës së saj brenda sistemit, ndërsa ndryshimet e bëra në instrumentet e analizës dhe të kategorizimit të çështjeve ua bëjnë më të lehtë përdoruesve që të krijojnë një ide të përgjithshme të qartë të analizës së materialit në secilin rast.

Pas transferimit në mjediset e reja në qershor të 2019, salla e re e gjyqit u testua gjerësisht për një periudhë dyjavore. Gjithsej në këtë proces ndihmuan rreth 60 punonjës nga i gjithë institucioni. Kjo punë u kurorëzua me një seancë gjyqi të simuluar, me pjesëmarrjen e ZPS-së, Zyrës së Mbrojtësve, Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave, Njësisë për Mbështetjen Juridike të Dhomave, Njësisë së Sigurisë dhe Njësisë për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, si edhe të disa vullnetarëve nga i gjithë institucioni të cilët ishin në rolin e dëshmitarëve dhe të publikut të gjerë.

Njësia për Administrimin e Gjykatës mbështeti dhe bashkërendoi organizimin e dy seancave të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese dhe një seance për apelet e punonjësve. Gjithashtu njësia krijoi edhe një dhomë të sigurt për ruajtjen e provave, si dhe punoi për finalizimin e politikave dhe procedurave që rregullojnë ofrimin e mbështetjes nga Zyra Administrative në disa fusha, si vizitat në vendngjarje, dhënia e deponimeve dhe dëshmimeve përmes videokonferencës.

#### Statistika për dosjet para Dhomave të Specializuara të Kosovës (duke përfshirë edhe dosjet e apeleve të punonjësve):

- 276 parashtrime të protokolluara
- 17 dokumente bazë, përfshirë përkthimin e tyre në gjuhët zyrtare
- 9 transkripte
- 526 kërkesa për përkthime

## 5.2 | Njësia e Përkthimit

Njësia e Përkthimit ofron shërbime përkthimi me gojë e me shkrim në tri gjuhët zyrtare të DHSK-së. Në vitin 2019, njësia vazhdoi të ofronte shërbimet e saj si në selinë e gjykatës, ashtu edhe gjatë misioneve në Kosovë dhe gjetkë. Njësia prodhoi 3.500 faqe përkthim në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, si edhe në gjuhë të tjera të kërkuara, për të mundësuar funksionimin efektiv dhe pa pengesa të DHSK-së.

Nga numri i gjithsejtë i faqeve të përkthyer, 1100 ishin përkthime zyrtare për gjykatën, në përgjigje të mbi 250 kërkesave për përkthim. Në to përfshiheshin parashtrime të protokolluara, rregullore të brendshme, si për shembull, Rregullorja e Përkohshme për Ndihmën Juridike, letërkëmbime dhe materiale për informimin publik. Shkalla e mbështetjes së Njesisë së Përkthimit për ZPS-në u rrit ndjeshëm gjatë këtij viti. Pjesa më e madhe e të gjitha përkthimeve, mbi 2.500 faqe nga 620 dokumente, u përkthyen për ZPS-së.

Për të ofruar udhëzime të qarta për gamën dhe përcaktimin e përparësive të shërbimeve gjuhësore, si edhe për të harmonizuar procesin e paraqitjes së kërkesave për shërbime përkthimi të njesisë, në vitin 2019 Administratorja miratoi dy dokumente: Politika e Zyrës Administrative për Përkthimet me gojë dhe me shkrim; dhe Udhëzimi i Zyrës Administrative për Parashtrimin e Kërkesave për Përkthim me Shkrim dhe me Gojë dhe Kërkesave për Verifikim.

Pak kohë pas transferimit në mjediset e reja, punonjësit e Njesisë së Përkthimit ndihmuan në provat e shumta teknike të sallës së gjyqit dhe të qendrës për median dhe dhanë vlerësimet e tyre për kabinat dhe pajisjet e përkthimit me gojë.

Gjatë vitit 2019, njësia mori pjesë në testimin dhe blerjen e një programi kompjuterik, i njohur si programi për përkthim të automatizuar neuronik, për t'u përdorur nga punonjësit e të dy institucioneve. Ky program u jep mundësi përdoruesve të kenë një përkthim pothuaj të menjëhershëm të automatizuar të një dokumenti.

Në kuadër të synimit për të krijuar një listë të profesionistëve më të mirë të përkthimit në profesion të lirë, të cilët nevojiten për të plotësuar punonjësit me orar të plotë në njësi, në fillim të vitit 2019 njësia shpalli dy tenderë të rëndësishëm për shërbime përkthimi me shkrim dhe redaktimi në shqipe, serbishte dhe anglishte, si edhe për përkthyes me gojë në sallën e gjyqit.

Në vitin 2019, Njësia e Përkthimit prodhoi mbi 3.500 faqe përkthimi.

## 5.3 | Zyra e Mbrojtjes

Zyra e Mbrojtjes (ZM) administron një Listë të Mbrojtësve që plotësojnë kriteret për ushtrimin e profesionit para DHSK-së si mbrojtës të specializuar. Gjithashtu, ajo administron sistemin e ndihmës juridike për përfaqësimin e të dyshuarve dhe të akuzuarave të varfër ose pjesërisht të varfër. Zyra e Mbrojtjes është asnjë dhe nuk luan asnjë rol në administrimin konkret të çështjeve para DHSK-së. Duke ndjekur ritmin e punës së Prokurorit të Specializuar, sistemi i ndihmës juridike, përfshirë edhe verifikimin e mjeteve financiare, u vu në praktikë në vitin 2019.

### Rregullorja e Ndhmës Juridike

Gjatë vitit 2019, Zyra e Mbrojtjes kreu disa verifikime lidhur me të drejtën e përfitimit të ndihmës juridike për personat që kishin paraqitur kërkesë për ndihmë juridike për shkak të ftesës së ZPS-së për t'u paraqitur për intervistë.

Këto verifikime u kryen në bazë të Rregullores së Përkohshme të Ndhmës Juridike, miratuar më 2019. Ato rezultuan në verifikime rigorozë të varfërisë, duke mundësuar kështu një administrim të shëndoshë financiar nga ana e DHSK-së. Si rrjedhojë, Administratorja vendosi që një numër personash i plotësonin kriteret për t'u cilësuar të varfër dhe u akordoi ndihmë juridike përmes caktimit të mbrojtësve. Disave prej atyre që bënë kërkesë iu refuzua ndihma juridike për shkak se verifikimet e kryera nga Zyra e Mbrojtjes treguan se ata kishin mjete të mjaftueshme për të siguruar përfaqësim ligjor për vete.

Në mars 2019, Administratorja, me miratimin e Kryetares dhe pas konsultimeve me Prokurorin e Specializuar, gjykatësit dhe mbrojtësit e Listës, miratoi Kodin e Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara. Ky dokument rregullon standardet e sjelljes profesionale në proceset gjyqësore para DHSK-së dhe siguron integritetin e procedurave, si edhe administrimin e drejtë e të duhur të drejtësisë. Gjithashtu ajo rregullon regjimin disiplinor në rast të ndonjë pretendimi për sjellje kundërvajtëse.

### Ngritja e Organit Përfaqësues të Pavarur

Një grup pune i përbërë nga mbrojtës të Listës së Mbrojtësve të Specializuar, hartoi me ndihmën e DHSK-së, një projekt-kushtetutë për Organin Përfaqësues të Pavarur të Mbrojtësve (OPP), sikundër parashikohet në kornizën ligjore të DHSK-së. Grupi i punës u mbledh në Hagë në fund të tetorit dhe fillim të nëntorit për të finalizuar Kushtetutën, e cila u miratua në dhjetor nga mbrojtësit e Listës përmes një procesi votimi elektronik. Me miratimin e Kushtetutës, OPP-ja quhet zyrtarisht e ngritur. Ajo do të bëjë të mundur konsultimet dhe bashkëpunimin midis DHSK-së dhe mbrojtësve për ndryshime në kornizën ligjore të DHSK-së.

Pas miratimit të Direktivës për Mbrojtësit më 2017, e cila përcakton kërkesat për mbrojtësit që do pranohen në Listat e Mbrojtësve, gjithsej 167 avokatë nga Kosova dhe vende të tjera janë pranuar si mbrojtës të specializuar dhe/ose mbrojtës të viktimave që kanë të drejtë të ushtrojnë profesionin para DHSK-së.

Ftesa për kërkesa për pranim në Listën e Mbrojtësve është e hapur. Zyra e Mbrojtjes dhe Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Viktimave vazhduan të vlerësonin kërkesat e reja gjatë gjithë 2019.

## 5.4 | Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (ZPV) administron sistemin e pjesëmarrjes së viktimave, përpilon Listën e Mbrojtësve të Viktimave që kanë të drejtë të paraqiten para DHSK-së, si dhe administron sistemin e pagesave për përfaqësimin juridik të viktimave pjesëmarrëse.

Sipas Ligjit, viktimat marrin pjesë në një apo më shumë grupe dhe ushtrojnë të drejtat e tyre përmes mbrojtësve që u caktohen.

Gjatë vitit 2019, ZPV-ja organizoi takime informuese me përfaqësues të komuniteteve të viktimave të mundshme, për të rritur ndërgjegjësimin e tyre në

lidhje me DHSK-në, rolin e kësaj zyre, të drejtat e viktimave pjesëmarrëse dhe sistemin e pjesëmarrjes së viktimave. ZPV-ja u takua me përfaqësues të komuniteteve rome, ashkali, egjiptiane dhe të pakicave të tjera, si edhe me komunitetet serbe dhe të Kishës Ortodokse në Kosovë. ZPV-ja zhvilloi takime me anëtarë të të katër degëve të Shoqatës së Familjeve të Personave të Rrëmbyer dhe të Zhdukur në Kosovë të cilët i informoi në lidhje me DHSK-në dhe sistemin e pjesëmarrjes së viktimave.

### Kush është viktimë pjesëmarrëse në proceset gjyqësore para DHSK-së?

Një person që ka pësuar dëmtim fizik, material apo mendor si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e një krimi të pretenduar në një aktakuzë të konfirmuar nga gjykatësi i procedurës paraprake mund të marrë statusin procedural të viktimës pjesëmarrëse në Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Pas konfirmimit dhe bërjes publike të një aktakuze, çdo person mund t'i bëjë kërkesë Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave për t'u pranuar si viktimë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake apo nga Trupi Gjykses.

## 5.5 | Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve

Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) është përgjegjëse për sigurimin e mbrojtjes dhe mbështetjes së dëshmitarëve në bazë të kornizës ligjore të DHSK-së. Në 2019, ajo krijoi një kornizë të fortë për zbatimin e masave të sigurisë dhe të mbrojtjes.

ZMMD-ja ka një personel me përvojë dhe të specializuar dhe kapacitete të plota për të ofruar mbrojtje dhe mbështetje për dëshmitarët para DHSK-së, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe kërkesat e parashikuara në Ligj dhe në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

Në vitin 2019, ZMMD-ja hartoi praktika pune të standardizuara dhe sistematike për rritjen e gatishmërisë operative dhe bashkëpunimin me autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare, për administrimin e informacionit për dëshmitarët dhe përmbushjen e kërkesave operacionale, dhe për lehtësimin e hyrjes në Holandë të dëshmitarëve dhe viktimave që marrin pjesë në proceset gjyqësore.

Kalimi në mjediset e reja të DHSK-së në qershor 2019 bëri të mundur që të krijohet një dhomë e sigurt pritjeje pranë sallës së gjyqit, për përdorim vetëm nga dëshmitarët. Dhomat e pritjes janë plotësisht të pajisura për t'u ofruar dëshmitarëve një mjedis pritjeje të rehatshëm dhe privat.

Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve ka përforcuar funksionet e saj mbështetëse, duke siguruar ofrimin e shërbimeve për dëshmitarët që mund të jenë të traumatizuar dhe të cenueshëm, duke marrë parasysh gjininë, kulturën dhe nevojat e tjera të veçanta të tyre.

## 5.6 | Njësia e Paraburgimit

Në përputhje me nenin 34(12) të Ligjit, Administratorja është përgjegjëse për administrimin dhe drejtimin e paraburgimit dhe objektit të paraburgimit të DHSK-së, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Njësia e Paraburgimit (NJP) administron dhe drejton objektin e paraburgimit të DHSK-së, duke siguruar që personat e paraburgosur nën autoritetin e DHSK-së të mbahen të ndaluar në përputhje me standardet ndërkombëtare, praktikat më të mira dhe dispozitat ligjore të zbatueshme. Një detyrë kyçe e Njesisë së Paraburgimit është të sigurojë që të paraburgosurit e mbajtur prej saj të mund të marrin pjesë në procese para DHSK-së në mënyrë të mbrojtur dhe të sigurt.

### Funksioni i paraburgimit

Në vitin 2019 u përgatit Rregullorja e Paraburgimit. Rregullorja administron çështje të tilla si vizitat dhe komunikimet e të paraburgosurve, ankesat, disiplina, dhe u mundëson të paraburgosurve qasje të plotë tek mbrojtësit e tyre.

Ajo u hartua duke iu përmbajtur standardeve të zbatueshme ndërkombëtare, përfshirë sidomos Rregulloren Evropiane të Burgjeve dhe Rregulloren e Standardeve Minimale të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve, që shpesh njihet me emrin Rregullorja e Nelson Mandelës.

Në tetor, u arrit një marrëveshje me Shërbimin Holandez të Burgjeve dhe Ministrinë Holandeze të Punëve të Jashtme lidhur me organizimin e objektit të paraburgimit. Nga fundi i vitit 2019, përfundoi përzgjedhja e oficerëve të paraburgimit.

Sikundër parashikohet në Ligjin dhe Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) dhe Avokati i Popullit i DHSK-së kanë të drejtë të kryejnë inspektime në objektin e paraburgimit. Në janar të vitit 2019, hyri në fuqi marrëveshja midis DHSK-së dhe KNKK-së për vizitat tek të paraburgosurit.

## 6 | Seksioni i Administratës

Seksioni i Administratës ofron mbështetje administrative dhe teknike për DHSK-në dhe ZPS-në përmes njësive që e përbëjnë Seksionin. Këto janë: Njësia e Burimeve Njerëzore; Njësia e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit; Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme; Njësia e Sigurisë; Njësia e Financave dhe Buxhetit; dhe Njësia e Prokurimit.

Gjatë vitit 2019, fokusi i punës së Seksionit ishte siguri i fillimit të operacioneve në mjediset e reja si

edhe vazhdimi i rekrutimit të personelit për të përmbushur nevojat operative të institucionit. Disa njësi punuan për përgatitjen e zyrave për të siguruar përshtatshmërinë e tyre për punë në përputhje me mandatet e DHSK-së dhe ZPS-së dhe për zhvendosjen e sigurt të personelit dhe të operacioneve. Ndërsa kjo punë arriti kulmin me lëvizjen në qershor të 2019, dhënia e dorës së fundit dhe përfundimi i të gjitha aspekteve të mjedisve vijoi gjatë gjithë vitit, duke u përqendruar sidomos tek salla e gjyqit.

### 6.1 | Njësia e Burimeve Njerëzore

Njësia e Burimeve Njerëzore (NJB NJ) u ofron mbështetje, këshilla dhe shërbime të gjithë punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së për çështje që kanë të bëjnë me burimet njerëzore. Ajo drejton procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes, administrimin e pagave, sigurimeve shëndetësore, fondit të pensioneve dhe përfitimeve të tjera, mirëqenien dhe trajnimin e punonjësve, si edhe procesin e vlerësimit të punës.


Në bazë të kompetencave të Administratores dhe për t'iu përgjigjur nevojave për administrimin efikas të burimeve njerëzore dhe për caktimin e punonjësve në përputhje me kërkesat e ngarkesës së punës, në vitin 2019 u miratuan disa caktime të përkohshme në detyrë dhe ndryshime organizative. Përzgjedhja e personelit vazhdoi të bazohej në nevojat operative, duke marrë parasysh balancën gjinore dhe shpërndarjen rajonale. Gjatë vitit 2019, DHSK-së dhe ZPS-së iu bashkuan 52 punonjës të rinj, duke çuar në rritjen e numrit të personelit nga 180 më 31 dhjetor 2018, në 203 më 31 dhjetor 2019.

DHSK-ja ka një program të konsoliduar për praktikantët që drejtohet nga Njësia e Burimeve Njerëzore (NJB NJ) dhe koordinatori i praktikantëve në Kabinetin e Administratores. Ky program u jep praktikantëve përvojë të rëndësishme pune dhe ofron gjithashtu seminare për tema të dobishme për t'i ndihmuar ata të ecin përpara në karrierat e tyre. Në të përfshiheshin prezantime lidhur me mandatin e DHSK-së, përfshirjen gjinore, zhvillimin e aftësive ndërkulturore, dhe përparimin në karrierë. Gjatë vitit 2019, 18 praktikantëve iu ofruan vende pune në DHSK dhe ZPS.



DHSK-ja dhe ZPS-ja u angazhuan me shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuese në nivel diplomatik dhe nxitën aktivisht shtetet që të emërojnë persona të kualifikuar për atashim në DHSK. Gjatë vitit 2019, numri i personelit të emëruar nga autoritetet shtetërore luhatej midis 13 dhe 15 punonjës, dhe më 31 dhjetor 2019 DHSK-ja kishte 14 punonjës të emëruar nga tetë shtete anëtare të BE-së (Bullgaria, Finlanda, Gjermania, Hungaria, Italia, Irlanda, Malta dhe Britania e Madhe) dhe një punonjës nga një shtet i tretë kontribues (SHBA).

### Përbërja e personelit të DHSK-së dhe ZPS-së sipas shteteve 31 dhjetor 2019




Kjo pasqyron një rritje të vazhdueshme jo vetëm të numrit të personave të emëruar nga shtetet, por edhe të numrit të shteteve emëruese.

Më 2019, njësia përgatiti dhe vuri në zbatim direktiva të rishikuara administrative dhe procedura standarde operative për tema të tilla si vlerësimi i punës dhe ricaktimi me detyrë për nevoja të institucionit. Pas miratimit të Kartës së Fondit të Kursimeve për Pensione, njësia, bashkë me palë të tjera të interesuara në institucion, organizoi mbledhjen e parë të përgjithshme vjetore për Fondin e Kursimeve për Pensione.


Në vitin 2019, njësia gjithashtu organizoi më se 20 veprimtari trajnimi në gjykatë, lidhur me tema si drejtimi dhe udhëheqja, kryerja e detyrave dhe përcaktimi i objektivave, si dhe ofroi kurse për mësimin e gjuhëve shqipe dhe serbe. Në takime informuese, punonjësit e rinj, praktikantët dhe kontraktorët u informuan për çështje që lidhen me burimet njerëzore, për strategjinë kundër mashtrimeve, si dhe për përkushtimin e palëkundur të gjykatës për të siguruar një vend pune përfshirës.

Në vijim të mbështetjes së mirëqenies së personelit, gjatë gjithë vitit punonjësve iu ofruan shërbime këshillimore psikologjike dhe u fillua një program për mirëqenien e personelit përmes një vargu takimesh në kohën e pushimit të drekës, për tema që lidhen me mirëqenien dhe shëndetin.

### Përbërja gjinore e personelit të DHSK-së dhe ZPS-së 31 dhjetor 2019



## Numri i përgjithshëm i personelit të DHSK-së dhe ZPS-së



## 6.2 | Njësia e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit

Njësia e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit (NJSHTI) ofron një teknologji informacioni të sigurt (TI) dhe shërbime audio vizuale në mbështetje të punës së DHSK-së. Në vitin 2019, njësia ka zhvilluar më tej infrastrukturën e TI-së dhe sistemet e programeve kompjuterike, në mbështetje të veprimtarive aktuale dhe të ardhshme gjyqësore.

Njësia e Teknologjisë së Informacionit u përfshi gjerësisht në përgatitjen e mjediseve të reja të DHSK-së dhe ZPS-së. Deri në qershor 2019, njësia realizoi infrastrukturën përfundimtare të TI-së dhe siguroi një transferim harmonik dhe pa probleme në zyrat e reja. Është bërë integrimi i aplikacioneve që mbështesin proceset gjyqësore dhe është siguruar realizimi në vijimësi i shërbimeve. Njësia vazhdoi bashkëpunimin e saj të ngushtë me shtetin pritës për konfigurimin dhe kapacitetet e sistemeve audiovizuale në sallën e gjyqit të DHSK-së, për të siguruar që teknologjia e zbatuar të mbështetë sa më mirë të gjitha aktivitetet e parashikuara të zhvillohen në sallën e gjyqit.

Me përfundimin e fazës së krijimit të infrastrukturës, gjatë vitit 2019, puna e njësisë u përqendrua tek operacionet në vijimësi, duke forcuar realizimin e proceseve të TI-së dhe kontrollet e sigurisë të nevojshme për të siguruar gatishmërinë e sistemit 24 orë në 7 ditë të javës. Për më tepër, njësia bëri të mundur që objekti i paraburgimit të DHSK-së të ketë lidhjet, pajisjet dhe aplikacionet e nevojshme të përshtatura për të, duke përfshirë pajisjet audiovizuale, për të lehtësuar pjesëmarrjen në seanca gjyqësore nga distanca.

Më 2019, Njësia e Teknologjisë së Informacionit e zgjeroi rrjetin e DHSK-së dhe shërbimet e tij duke përfshirë edhe ZPS-në. Personelit të ZPS-së tani i është mundësuar qasje në Legal Workflow, postë elektronike dhe dosje nga brenda zyrave të ZPS-së.

## 6.3 | Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme

Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme (NJAOSHP) është përgjegjëse për realizimin efikas dhe të efektshëm të shërbimeve mbështetëse për DHSK-në dhe ZPS-në. Kjo përfshin administrimin e pasurive të paluajtshme së bashku me shtetin pritës, mirëmbajtjen e ndërtimeve e godinave dhe planifikimin e hapësirave të punës, duke synuar sigurimin e një mjedisi cilësor pune për personelin dhe vizitorët që vijnë në organizatë. Njësia përgjigjet gjithashtu për shërbime të tilla si furnizimi i mensës, pritja e vizitorëve dhe pastrimi. Gjithashtu, ajo administron shërbimin e postës së rregullt dhe postës së sigurt, transportin, udhëtimet dhe logjistikën dhe punon ngushtësisht me Njësinë e Sigurisë dhe atë të Protokollit.

Transferimi i DSK-së dhe ZPS-së në mjediset e reja më 2019 ishte pika kulmore e planifikimit, përgatitjes dhe bashkëpunimit të gjerë me shtetin pritës gjatë viteve të fundit. Njësia bashkërendoi punën me shtetin pritës për të siguruar dorëzimin e një ndërtese që i përgjigjet kërkesave dhe qëllimeve të punës së DSK-së.

Kalimi në zyrat e reja në qershor u arrit pa asnjë ndërprerje të paplanifikuar të punës së DSK-së dhe ZPS-së dhe institucionet vazhduan të funksiononin pa asnjë problem që nga dita e parë.

Pas lëvizjes, mjediset e përkohshme në të cilat ishte vendosur gjykata më parë iu kthyen shtetit pritës.

Me t'u vendosur në zyrat e reja, njësia vijoi testimin dhe përmirësimin e shërbimeve të ofruara në zyrat e reja, duke i kushtuar vëmendje të veçantë sallës së gjyqit. Kjo punë konsistonte kryesisht në konfigurimin e mëtejshëm të sistemeve të sallës së gjyqit dhe u krye pa penguar përdorimin e saj. Njësia vazhdon bashkëpunimin me shtetin pritës dhe partnerët e saj për të siguruar që sistemet e administrimit mjedisor të ndërtesës dhe struktura e ndërtesës të funksionojnë me efikasitetin më të madh.

Një arritje e rëndësishme në vitin 2019 ishte përfundimi me sukses i projektit të transferimit në zyrat e reja dhe njësia organizoi transferimin e operacioneve dhe sistemeve të punës së DSK-së dhe ZPS-së nga zyrat e përkohshme në zyrat e përhershme në Raamweg 47, në Hagë.

## 6.4 | Njësia e Sigurisë

Më 2019, Njësia e Sigurisë (NJS) u mor kryesisht me zhvendosjen e institucionit dhe vënien në punë të zyrave të reja. Planifikimi dhe bashkërendimi efikas me autoritetet e shtetit pritës garanoi që lëvizja e DHSK-së dhe ZPS-së nga zyrat e përkohshme në ato të reja në qershor u krye në mënyrë të sigurt dhe me efikasitet. Përpara kësaj lëvizjeje, në mes të majit, njësia mori në dorëzim përgjegjësinë për sigurinë e mjediseve, pas një periudhe trajnimi profesional të një kontingjenti të ri të personelit të sigurisë i përbërë nga persona të emëruar dhe të kontraktuar nga shtete të ndryshme anëtare të BE-së. Njësia ofron shërbime në mjediset e reja 24 orë në çdo ditë të javës.

Përmbushja e kriterëve të legjislacionit të zbatueshëm të shtetit pritës lidhur me sigurinë dhe certifikimin e ndërtesave u arrit përmes një programi të gjerë për njohjen e ndërtesave për të gjithë personelin dhe kontraktuesit dhe me miratimin nga

shteti pritës të dokumenteve të planifikimit emergjent.

Gjatë vitit, Njësia e Sigurisë ofroi mbështetje të mëtejshme për aktivitete jashtë kufijve të shtetit pritës dhe forcoi sistemin ekzistues të menaxhimit të rreziqeve të lidhura me udhëtimet. Sigurimi i një mjedisi pune të sigurt dhe promovimi i vazhdueshëm i një kulture të sigurisë që i përshtatet natyrës së punës vazhdoi të ishte në qendër të vëmendjes.

Njësia e sigurisë vazhdon të zhvillojë dhe ruajë bashkëpunim efikas me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë që kontribuojnë për monitorimin dhe vlerësimin efektiv të rrezikut dhe ofrojnë mbështetje të specializuar për mbrojtjen e punës dhe funksioneve bazë të DHSK-së dhe ZPS-së.

## 6.5 | Njësia e Financave dhe Buxhetit

DHSK-ja ka vazhduar të administrojë fondet e akorduara nga shtetet anëtare të BE-së gjatë vitit 2019, në përputhje me buxhetin e miratuar, shuma e gjithsejtë e të cilit për periudhën 15 qershor 2018 deri në 14 qershor 2020 ishte 86.250.000 euro. Kjo është periudha e tretë buxhetore dhe hera e parë që Këshilli Evropian miratoi një buxhet dyvjeçar për zbatimin e mandateve të DHSK-së dhe ZPS-së.

Përveç fondeve të dhëna nga BE-ja, DHSK-ja menaxhoi edhe fonde në shumën 80 milion korona të dhuruara nga qeveria norvegjeze për të mbështetur zhvendosjen e procedurave në mjediset e reja, dhe 181.200 euro nga qeveria zvicerane, për veprimtaritë e komunikimit dhe ndërgjegjësimit të DHSK-së gjatë 2018 dhe 2019.

Më 2019, Njësia e Financave dhe Buxhetit vijoi të mbështeste Administratoren në menaxhimin financiar dhe përdorimin e fondeve të dhëna DHSK-së, në përputhje me rregulloret dhe rregullat financiare të BE-së dhe ato të brendshme. Nën drejtimin e Administratores, njësia punoi për të siguruar një administrim efikas dhe autonom, përmes zbatimit të një sërë sistemesh, rregulloresh dhe procedurash që sigurojnë përdorimin e duhur dhe miradministrimin financiar të fondeve. Në lidhje me këtë, gjatë vitit 2019 Administratorja nxori ose përditësoi më shumë se dhjetë direktiva administrative, të cilat trajtojnë aspekte kyçe të cikleve financiare të DHSK-së dhe ZPS-së.

Verifikime të pavarura të shpenzimeve të llogarive financiare kryhen rregullisht nga një firmë ekspertësh auditues në përputhje me marrëveshjen për subvencion. Gjithashtu, duke qenë një organizatë e financuar nga BE-ja, DHSK-ja dhe ZPS-ja auditohen, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, edhe nga Gjykata Evropiane e Auditorëve dhe nga Shërbimet e Auditimit të Brendshëm të Komisionit Evropian. Gjatë vitit 2019, të gjitha auditimet dhe verifikimet e shpenzimeve nuk bënë asnjë konstatim.

Në fund të çdo periudhe raportimi buxhetor, raportet e mbylljes së llogarive dhe verifikimit të shpenzimeve dorëzohen në Shërbimin e Instrumentit të Politikës së Jashtme të Komisionit Evropian. Më 2019,

marrëveshja e parë për subvencion e nënshkruar midis Administratores dhe Komisionit Evropian për periudhën 15 qershor 2016 deri në 14 qershor 2017 u mbyll me sukses pa identifikuar asnjë mosplotësim kriteresh.

Si rezultat i rregullave dhe procedurave të shëndosha financiare, verifikimet e shpenzimeve të DHSK-së vazhdojnë të mos bëjnë asnjë konstatim financiar dhe DHSK-ja e ka mbyllur marrëveshjen e parë të subvencionimit me BE-në pa asnjë konstatim për mosplotësim kriteresh.

## 6.6 | Njësia e Prokurimit

Njësia e Prokurimit është përgjegjëse për të gjitha prokurimet e DHSK-së dhe ZPS-së dhe për kontraktimin e furnizimeve, shërbimeve dhe punimeve. Përveç kësaj, njësia siguron që institucionet të jenë në përputhje me rregullat e BE-së për veprimet prokurorese të saj. Gjithashtu, ajo mbështet institucionet në menaxhimin dhe monitorimin e kontratave si edhe në ofrimin e trajnimeve të rregullta të personelit të brendshëm dhe mbajtësve të buxhetit për procesin e prokurimit dhe përgjegjësitë për menaxhimin e kontratave.

Në vitin 2019, njësia menaxhoi veprimtari të shumta prokurimi që në një masë të madhe ishin të lidhura me transferimin në mjediset e reja. Nga pothuaj 200 veprime prokurimi të ndërmarra në vitin 2019, 135 prej tyre rezultuan në dhënie kontratash me një vlerë të gjithsejtë prej rreth 6,4 milion euro.


Një numër i konsiderueshëm i 135 kontratave të lidhura në 2019 kishin të bënin me ofrimin e shërbimeve këshillimore në fusha të ndryshme të ekspertizës.

Gjatë gjithë vitit, njësia realizoi seanca trajnimi në institucion për të zhvilluar më tej njohuritë dhe aftësitë e personelit të DHSK-së dhe ZPS-së për temat e prokurimeve dhe të administrimit të kontratave.

Në vitin 2019, NJP-ja u angazhua në aktivitete të shumta në mbështetje të transferimit të suksesshëm në mjediset e reja dhe në përgatitje për veprimtari gjyqësore më intensive.



**Zyra e  
Prokurorit të  
Specializuar**



# Parathënie

Gjatë vitit 2019, puna e personelit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) i ka sjellë hetimet në fazën kur mund të fillojnë të merren vendime për ngritjen e akuzave. Ky përparim u bë i mundur vetëm në sajë të përkushtimit të palëkundur dhe angazhimit të palodhur të personelit të ZPS-së ndaj misionit tonë gjatë gjithë vitit.



Xhek Smith, Prokurori i Specializuar

Të gjitha vendimet për ngritje të akuzave do të mbështeten vetëm në ligj dhe në fakte. ZPS-ja është një institucion i pavarur. Ajo nuk bën llogari politike dhe punon me objektivitet, profesionalizëm dhe në mënyrë të paanshme.

I vetmi fokus i punës së ZPS-së është llogaridhënia individuale për krime të vërtetuara përtej dyshimit të arsyeshëm. Hetimet që unë kryesoj nuk përbëjnë asnjë sfidë ndaj ndonjë narrative të caktuar historike, por kërkojnë nxjerrjen para përgjegjësive të individëve për aktet e kryera prej tyre gjatë periudhës që mbulon mandati i ZPS-së.

U mbetem mirënjohës Bashkimit Evropian (BE), shteteve anëtare të tij dhe shteteve të treta kontribuese për burimet financiare dhe mbështetjen e nevojshme që na kanë vënë në dispozicion për të bërë të mundur kryerjen e hetimeve. Gjithashtu falënderoj edhe shtetin pritës, Holandën, për ndërtesat në të cilat kemi hyrë këtë vit. Dëshiroj t'u shpreh gjithashtu mirënjohjen kolegëve në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK), në veçanti, Kryetares Ekaterina Trendafilova dhe Administratores Fidelma Donlon, për punën dhe përpjekjet e tyre për krijimin e strukturave dhe procedurave të gjykatës, që na kanë mundësuar të kryejmë punën tonë.

Synimi im dhe i ekipit tim është të shpërblejmë besimin që na është dhënë për vendosjen e drejtësisë në këtë përpjekje të rëndësishme.

**Xhek Smith**  
*Prokurori i Specializuar*

*Shkurt 2020*



# Hetimet

**Gjatë vitit 2019, prokurorët dhe hetuesit e ZPS-së intervistuan viktimë, dëshmitarë dhe të dyshuar në Kosovë, në rajon, në Holandë dhe në vende të treta.**

Përveç mbledhjes së dëshmive, ZPS-ja është marrë gjithashtu me shqyrtimin e provave të mbledhura që nga fillimi i hetimeve për të gjykuar për vlerën dhe rëndësinë e tyre, si edhe për të siguruar që ato të jenë të pranueshme në gjykatë.

Një tregues i punës hetimore ka qenë lëshimi i fletëthirrjeve. Ky instrument i ndjekjeve penale ka kontribuar gjithashtu në rritjen e dukshmërisë të ZPS-së si në Kosovë ashtu edhe më gjerë në rajon.

ZPS-ja ka kompetencë, ndër të tjera, të kërkojë paraqitjen dhe të marrë në pyetje të dyshuar, viktimë dhe dëshmitarë, të mbledhë dhe shqyrtojë

informacione dhe prova dhe të marrë vendime për fillimin dhe vazhdimin, ose mbylljen e proceseve penale. Qëllimi i saj është që t'i nxjerrë para përgjegjësisë individët që kanë kryer krimet e përfshira në mandatin e saj.

Të gjithë anëtarët e personelit të ZPS-së - prokurorët, hetuesit, punonjësit e sigurisë, specialistët e mbrojtjes së viktimave dhe punonjësit që merren me mbështetjen e tyre – janë ndërkombëtarë.

Ndihma si nga shtetet anëtare të BE-së, ashtu dhe nga komuniteti më i gjerë ndërkombëtar është thelbësore për hetimet. ZPS-ja ka kërkuar dhe vazhdon të kërkojë ndihmë nga këto autoritete dhe institucione, të brendshme dhe ndërkombëtare, për t'i çuar hetimet përpara.



# Historiku i ZPS-së

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) u krijua në Hagë më 1 shtator 2016 Hagë, duke trashëguar personelin dhe mandatin e Task Forcës Hetimore Speciale (TFHS).

TFHS-ja u krijua në vitin 2011 në Bruksel si një njësi brenda Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, për të hetuar pretendimet e ngritura në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës "Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë" (Raporti i KiE-së), i cili u botua në fillim të vitit 2011.

Hetimet e TFHS-së u drejtuan nga Klint Uilliamson (Clint Williamson), prokuror nga Shtetet e Bashkuara (SHBA) dhe ish-ambasador i Shteteve të Bashkuara për çështje të krimeve të luftës.

Mandati i ZPS-së buron nga Amendamenti nr. 24 të Kushtetutës së Kosovës dhe nga Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, miratuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015, në bazë të të cilëve u krijuan ZPS-ja dhe Dhomat e

Specializuara të Kosovës. Ky legjislacion i jep ZPS-së autoritetin për të hetuar dhe ndjekur penalisht krime të kryera në lidhje me sjellje të identifikuar në Raportin e Këshillit të Evropës dhe të hetuara nga TFHS-ja.

Krimet që bëjnë pjesë në juridiksionin e ZPS-së janë krime të kryera apo të nisura në Kosovë, apo të kryera nga, apo kundër personave me shtetësi kosovare/të Republikës Federative të Jugosllavisë, në periudhën trevjeçare nga 1 janari 1998 deri në 31 dhjetor 2000. Ajo ka të drejtë gjithashtu të hetojë dhe procedojë krime që lidhen me pengimin e drejtësisë.

ZPS-ja është një institucion i pavarur dhe pavarësia e saj garantohet nga Ligji që e krijoi atë.

Rrjedhimisht, ZPS-ja ka detyrimin të veprjë në mënyrë të pavarur nga DHSK-ja dhe nga të gjithë prokurorët e tjerë në Kosovë. Ligji gjithashtu e udhëzon Prokurorin e Specializuar dhe personelin e ZPS-së që të mos kërkojë apo marrë udhëzime nga ndonjë qeveri apo ndonjë burim tjetër.

# Aktakuza

**Në përputhje me nenin 38(4) të Ligjit dhe rregullën 86 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, përpara se të ngrëjë një aktakuzë, Prokurori i Specializuar duhet të bindet se "ka një dyshim të bazuar mirë se një i dyshuar ka kryer apo ka marrë pjesë në kryerjen e një krimi brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara".**

Pasi Prokurori i Specializuar ngrë një aktakuzë para Dhomave të Specializuara, Kryetarja e DHSK-së cakton një gjykatës të procedurës paraprake për ta shqyrtuar atë. Gjykatësi i procedurës paraprake mund ta konfirmojë aktakuzën, nëse bindet se ka

dyshime të bazuara mirë në lidhje me akuzat që janë ngritur. Gjithashtu, gjykatësi i procedurës paraprake ka kompetencë të japë vendim për çdo mocion paraprak, përfshirë edhe kundërshtimet ndaj aktakuzës dhe juridiksionit, si edhe të lëshojë urdhra ose vendime për të siguruar përgatitjen e duhur dhe të shpejtë të çështjes për gjykim.

Pas shqyrtimit fillestar dhe pasi të jenë zgjidhur çfarëdo çështjesh paraprake, si kundërshtimet e mundshme ndaj juridiksionit të DHSK-së, gjykatësi i procedurës paraprake vendos se çështja është gati për gjykim.

## Raportime diplomatike

Gjatë vitit 2019, Prokurori i Specializuar Xhek Smith ka bërë një numër raportimesh diplomatike për t'u dhënë shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese informacion të përditësuar mbi punën e ZPS-së, pengesat e ndeshura prej saj dhe mënyrat se si mund ta ndihmojë komuniteti ndërkombëtar ZPS-në për të përshpejtuar hetimet e saj.

Në qershor, Prokurori i Specializuar Smith foli përpara Komitetit Politik dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian në Hagë, së bashku me Kryetaren e DHSK-

së Ekaterina Trendafilova dhe Administratoren Fidelma Donlon, ndërsa në mbledhjen e këtij komiteti në tetor në Bruksel ai u paraqit i vetëm. Gjithashtu, u foli edhe diplomatëve që përfaqësojnë shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuese në dhjetor në Hagë, së bashku me Kryetaren Trendafilova dhe Administratoren Donlon.

Mbështetja e komunitetit më të gjerë ndërkombëtar ka qenë dhe vazhdon të jetë me rëndësi kritike për punën dhe veprimtarinë e ZPS-së.



Prokurori i Specializuar në raportimin vjetor, dhjetor 2019

## Personeli

ZPS-ja është parashikuar të ketë 78 punonjës, përfshirë prokurorë, këshilltarë juridikë, hetues, analistë, specialistë për sigurinë e dëshmitarëve dhe personel mbështetës. Në fund të vitit 2019, 58 nga këto poste, ose 74 %, ishin plotësuar me punonjës që përfaqësojnë 19 shtete të BE-së dhe shtete të treta

kontribuese. Nga personeli i ZPS-së, 52 janë punësuar drejtpërdrejt ndërsa gjashtë janë emëruar nga shtetet. Janë shpallur trembëdhjetë vende të lira pune dhe në dhjetor 2019 procesi i plotësimit të këtyre posteve ishte ende në vazhdim.

## Personeli i Lartë i Prokurorisë

**Prokurori i Specializuar Xhek Smith kryeson një ekip prokurorësh me përvojë, shumica e të cilëve, ashtu si vetë Prokurori i Specializuar, kanë përvojë në fushën e ndjekjeve penale si në juridiksionet e brendshme të shteteve të tyre, ashtu edhe në tribunalë ndërkombëtarë.**

Zëvendësprokuror i Specializuar është Kwai-Hong Ip (Kwai-Hong Ip), i cili ka punuar në këtë post që prej krijimit të ZPS-së, ndërsa më parë, duke filluar nga 2012, ishte zëvendëskryeprokuror i TFSH-së. Nga 2010 deri në 2012, zoti Ip ishte prokuror në proceset gjyqësore të Tribunalit Special për Libanin në Hagë. Ndërsa nga 2005 në 2009, zoti Ip punoi si prokuror ndërkombëtar në Prokurorinë e Bosnjë-Hercegovinës, ku kreu hetime dhe procedime të personave përgjegjës për gjenocidin e Srebrenicës në korrik 1995. Në këtë cilësi, ai procedoi me sukses çështjen e parë gjyqësore për gjenocid në Bosnjë-Hercegovinë dhe tri çështje të tjera lidhur me Srebrenicën.

Më herët në karrierën e tij z. Ip ka punuar si jurist në Misionin e Kombeve të Bashkuara (KB) në Kosovë, si ndihmëskëshilltar juridik në Forcat e udhëhequra nga NATO në Kosovë, si prokuror ushtarak në Forcat Ajrore Mbretërore (RAF) dhe si komandant i misionit të helikopterëve të RAF-it. Në fillim të këtij viti, zotit Ip, shtetas i Britanisë së Madhe, iu akordua titulli Oficer i Urdhrit të Perandorisë Britanike për shërbime në fushën e drejtësisë penale ndërkombëtare.

Alan Tiger (Alan Tieger) është Prokuror i lartë i ZPS-së, me shtetësi amerikane dhe përvojë të gjerë si në Shtetet e Bashkuara ashtu edhe në Tribunalin Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë (TPNJ). Zoti Tiger ka punuar si në gjykimin e pare në TPNJ, në çështjen e Dushko Tadiqit, ashtu edhe në gjykimin e fundit në atë institucion, në çështjen gjyqësore të Ratko Mlladiqit. Ai ka punuar edhe si prokuror i lartë në gjyqet e Ante Govotinës, Radovan Karaxhiqit, Momçillo Krajshnikut, Darko Mërgjas dhe Biljana Pllavshiqit.

Zoti Tiger ka punuar si prokuror federal në Seksionin Penal të të Drejtave Civile në Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara nga 1987 në 1994, ku procedoi çështje të dhunës racore dhe brutalitetit policor në të gjithë vendin, përfshirë çështjen e Rodni King. (Rodney King)



*Kwai-Hong Ip,  
Zëvendësprokuror i  
Specializuar*



*Alan Tiger, Prokuror i Lartë*

Ai ka një diplomë nga Universiteti i Kalifornisë në Los Anxheles ndërsa studimet e doktoratës në fushën e drejtësisë i përfundoi në Universitetin e Santa Klarës.

Shefi i Hetimeve të ZPS-së është Aleks Uajting (Alex Whiting), një prokuror me shtetësi franceze dhe amerikane, me përvojë të gjerë pune në fushën e ndjekjeve penale, si në juridiksione të brendshme ashtu dhe ndërkombëtare, ku përfshihen periudha pune në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (GJPN) dhe në TPNJ, si edhe me një karrierë të shquar akademike.

Zoti Uajting, u diplomua në Kolegjin dhe Fakultetin e Drejtësisë të Jeilit (Yale), dhe iu bashkua ZPS-së pasi kishte punuar si profesor i praktikës juridike në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Harvardit që prej vitit 2013. Në GJPN, ku punoi nga 2010 deri në 2013, zoti Uajting ka qenë në zyrën e Prokurorit të GJPN-së ku fillimisht punoi si Koordinator i Hetimeve për mbikëqyrjen e të gjitha hetimeve, dhe më vonë si Koordinator i Procedimeve për mbikëqyrjen e të gjitha procedimeve penale.

Në TPNJ, ku punoi nga 2002 në 2007, zoti Uajting ishte kryeprokuror në gjyqin e Fatmir Limajt, Isak Musliut, dhe Haradin Balajt, dhe kryeprokuror në gjyqet e Millan Martiqit dhe Dragomir Millosheviqit.

Përpara punës në TPNJ, zoti Uajting ka qenë prokuror federal në SHBA, së pari në Seksionin Penal të Departamentit të Drejtave Civile në Uashington, DC, dhe pastaj në Zyrën e Prokurorit të Shteteve të Bashkuara në Boston, Masaçusets (Massachusetts), ku u mor me çështje të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Kler Lousën (Clare Lawson) është shefe e ekipit këshillimor juridik. Zonja Lousën ka shtetësi irlandeze dhe u diplomua nga Kolegji i Universitetit të Dublinit. Ajo kreu një vit specializim në fushën e së drejtës ndërkombëtare në Universitetin e Melburnit dhe mori titullin Magjistër në Drejtësi nga Universiteti i Kolumbias. Përpara se të fillonte punë në ZPS, zonja Lousën ka punuar si juriste në Seksionin e Gjykimeve në GJPN, në Zyrën e Prokurorit të TPNJ-së, si këshilltare e të drejtave të njeriut në qeverinë irlandeze, dhe si avokate në një firmë ligjore të shquar irlandeze.

Zonja Losën ka punuar në një numër çështjesh penale ndërkombëtare, përfshirë ato që kanë të bëjnë me Republikën e Afrikës Qendrore, Republikën Demokratike të Kongos, Kenian dhe ish-Jugosllavinë . Ajo ka kryesuar gjithashtu negociata për të drejtat e njeriut në emër të BE-së dhe në OKB.



Aleks Uajting, Shefi i hetimeve



Kler Losën, Përgjegjëse e Ekipit Ligjor Këshillimor



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E  
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

## **DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS DHE ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR RAPORTI I VITIT 2019**

### **Botuar dhe shpërndarë nga:**

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK)

### **Botuar në tri gjuhë:**

Anglishte, shqipe, serbishte

### **Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të DHSK-së:**

[www.scp-ks.org](http://www.scp-ks.org)

### **Për pyetje nga mediat në lidhje me Dhomat e Specializuara të Kosovës:**

[mediaKSC@scp-ks.org](mailto:mediaKSC@scp-ks.org)

### **Për pyetje nga mediat në lidhje me Zyrën e Prokurorit të Specializuar:**

[spokespersonSPO@scp-ks.org](mailto:spokespersonSPO@scp-ks.org)

### **Paraqitja grafike:**

Wim Jansen Design

[www.wimjansendesign.nl](http://www.wimjansendesign.nl)

### **Fotografitë e sallës së gjyqit:**

Henri Smeets

[C360.nl](http://C360.nl)

### **Shtypur nga:**

Quantes Grafimedia

[www.quant.es.nl](http://www.quant.es.nl)

**E drejta e autorit- © 2020 Dhomat e Specializuara  
dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës.**

**Të gjitha të drejtat të rezervuara.**



[www.scp-ks.org](http://www.scp-ks.org)